

BAHRI BECI

-62-

REALIZIME TË GJUHËSISË SHQIPTARE NË STUDIMIN E HISTORISË SË GJUHËS SHQIPE GJATË KËTYRE 25 VJETVE

Shkencat albanologjike, pjesë përbërëse e procesit të madh të zhvillimit ekonomik e kultural të vendit tonë, bëjnë sot bilancin e fitoreve të arritura në studimin e vlerave materiale e shpirtërore të popullit tonë gjatë këtyre 25 vjetve të pushtetit popullor. Studimi i historisë së gjuhës shqipe është njëri nga aspektet e këtyre kërkimeve, që shquhet për një sërë realizimesh të rëndësishme me interes, të cilat kanë ndihmuar në ndriçimin e së kaluarës, të sotmes dhe të perspektivës së gjuhës sonë.

Karakteristikat themelore të kërkimeve në fushën e historisë së gjuhës shqipe të këtyre 25 vjetve janë këto: ① ndryshe nga albanistika e huaj e gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe e gjysmës së parë të shekullit XX, e cila i kishte vënë vetes si detyrë themelore «të zbulonte se ç'e bashkonte shqipen me gjuhët e tjera indoevropiane dhe ç'e dallonte prej tyre»¹, pra studimin e historisë së jashtme të saj, gjuhësia shqiptare e paslirimit i vuri vetes si detyrë themelore të studjonte historinë e zhvillimit të saj të brendshëm. Duhet pranuar se «me vëmendjen që u kushtoi Pedersen fakteve të vetë gjuhës shqipe dhe rikonstruksionit të brendshëm mbi bazën e studimit krahasues historik, fillon të përvijohet një drejtim i ri në albanistikën e huaj, i cili u përforcua më vonë nga Jokli, Lamberci, Bariçi, Taljavini, Bartoli etj.»². Mirëpo ky drejtim, që për atë periudhë mund të thuhet se ndodhej vetëm në hapat e para, sot është bërë karakteristika themelore e kërkimeve në fushën e studimit të historisë së gjuhës shqipe; ② ndërsa albanistika e huaj i përpunoi problemet e historisë së jashtme të shqipes (a. problemin e përkatësisë së shqipes në rrethin e gjuhëve indoevropiane; b. problemin e burimit të saj; c. problemin e dallimit të elementit të huazuar nga ai autokton; d. problemin e lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike), duke u mbështetur, për shkak të prapambetjes së dialektologjisë, në një material relativisht të kufizuar nga fusha e shqipes³, gjuhësia shqiptare e këtyre 25 vjetve përpunoi problemet e historisë së brendshme të saj, duke u mbështetur në një material faktik të pasur nga shqipja, të grumbulluar nga dialektologët e leksikologët tanë gjatë këtyre 25 vjet-

1) A. Kostallari, *Gjendja e studimeve albanologjike në Shqipëri. Probleme dhe detyra të reja*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21 nëndor 1962)», Tiranë 1965, f. 27. (Shih edhe botimin frëngjisht në «Studia Albanica» 1964, I.

2) A. Kostallari, *Po aty*, f. 27.

3) A. Kostallari, *Po aty*, f. 27.

ve, si edhe në të dhënat e dokumentave të vjetra të shkrimit. Ajo, duke u mbështetur në një bazë faktike më të gjerë nga fusha e shqipes, dha gjithashtu një kontribut të vyer edhe në ndriçimin dhe argumentimin e mëtejshëm të problemeve të historisë së jashtme të saj, të ngritura nga albanistika e huaj: 3. ndryshimi i objektit përcaktoi edhe ndryshimet në metodën e zbatuar. Ndërsa albanistika e huaj shfrytëzoi kryesisht «metodën e gjuhësisë historike krahasuese me dobësitë dhe përmirësimet e saktësimet që pati ajo gjatë një shekulli e gjysmë»⁴, gjuhësia shqiptare në studimin e historisë së gjuhës sonë vuri në qendër të vëmendjes metodën e rikonstruktimit të brendshëm, pa lënë krejt në një anë edhe metodën krahasuese tradicionale.

Të gjitha këto e afruan studimin e historisë së gjuhës shqipe më afër problemeve të kohës, duke bërë, në këtë mënyrë, që ajo, megjithëse historike, t'i shërbejë më mirë dhe në mënyrë më direkte zgjidhjes së detyrave të së sotmes dhe të perspektivës.

Studimi i historisë së gjuhës shqipe gjatë këtyre 25 vjetve ka ecur në këto dy drejtime themelore: 1) në drejtim të përgjithësimit kritik të realizimeve të arritura në këtë lushë nga shkenca gjuhësore, sidomos në periudhën që nga mesi i shekullit XIX, kur Franc Bopi argumentoi përfundimisht përkatësinë e shqipes në familjen gjuhësore indoevropiane; 2) në drejtim të thellimit dhe argumentimit të mëtejshëm të shumë problemeve të trajtuara më parë, si edhe të ngritjes dhe zgjidhjes së mjaft problemeve të reja.

1) Përgjithësimi kritik i trashigimisë së kaluar në fushën e historisë së gjuhës shqipe, të fonetikës dhe të morfologjisë historike të saj është bërë në dy punime të rëndësishme të botuara në formë dispense respektivisht nga E. Cabej e M. Domi i pari botuar për herë të parë më 1947 nën titullin «Albanologji»⁵, në një botim të dytë më 1959 e në një të tretë më 1960 nën titullin: «I. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe; II. Fonetika historike e shqipes»⁶ dhe i dyti më 1961 nën titullin «Morfologjia historike e shqipes»⁷.

Në këto punime, përveç përgjithësimit kritik të rezultateve të arritura në këto fusha nga mesi i shekullit XIX deri afër mesit të shekullit XX kryesisht nga albanologët e huaj, janë formuluar edhe teza të reja, disa prej të cilave janë bërë më vonë objekt studimesh të veçanta.

Këto punime, përveç vështirësive me karakter shkencor, kanë kapërcyer edhe një sërë vështirësish me karakter metodik, duke ja dalë kështu të na japin në një formë të sistemuar vijat themelore të zhvillimit të shqipes që nga periudha prehistorike e saj deri në ditët e sotme.

Këto punime kanë shërbyer si mbështetje në hartimin e punimeve sintezë të mëvonshme për historinë e gjuhës shqipe të hartuara përkatësisht nga H. Bariç e I. Ajeti⁸.

Një pasqyrë përmbledhëse e elementeve më kryesore të strukturës gramatikore të shqipes në planin diakronik është dhënë në artikullin

4) A. Kostallari, *Po aty*, f. 26.

5) *Albanologji*, Tiranë 1947, dispensë bôtuar pa emër autori.

6) E. Cabej, I. *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*; II. *Fonetika historike e shqipes*, botim I, Tiranë 1959; botim II 1960 (dispensë).

7) M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, Tiranë 1961 (dispensë).

8) H. Bariç, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1955.

I. Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1969.

e M. Domit «L'albanais et sa structure grammaticale» (Shqipja dhe struktura e saj gramatikore)⁹.

2) Cështjet themelore që u thelluan dhe u argumentuan më tej, si edhe problemet e reja që u ngritën dhe u zgjidhën nga gjuhësia shqiptare e pasçlirimit në fushën e studimit historik të shqipes janë I. sqarimi i mëtejshëm i problemeve të historisë së jashtme të shqipes, II. zbulimi i elementeve të sistemit fonetik e morfologjik indoevropian të saj si edhe i ligjeve që kanë vepruar në periudhat e ndryshme të zhvillimit të saj.

I

Problemet themelore që janë rrokur nga gjuhësia shqiptare e pasçlirimit në studimin e historisë së jashtme të saj janë: 1) karakteri indoevropian i shqipes dhe vendi i saj në rrethin e gjuhëve të afërta me të; 2) burimi i shqipes dhe djepi i shqiptarëve në Ballkanin e vjetër; 3) marrëdhënjet e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit në periudhën historike.

Nga këto kanë tërhequr më shumë vëmendjen dhe janë ndriçuar më gjerësisht problemi i djepit të shqiptarëve në Ballkanin e vjetër (autoktonia e tyre) dhe problemi i burimit të shqipes, probleme këto me rëndësi jo vetëm për historinë e gjuhës shqipe, por edhe për historinë e popullit tonë e të popujve të Ballkanit. Pikërisht në zgjidhjen e këtyre problemeve disa nga përfaqësuesit e albanistikës së huaj nuk u kanë shpëtuar qëndrimeve subjektive e aprioristike. Gjuhësia shqiptare në ndriçimin e këtyre problemeve ka synuar të ecë me një hap sa më të matur e të jetë sa më objektive.

Po lejohemi tashti të parashtrijmë simbas një rendi tematik disa nga rezultatet konkrete kryesore, që u shënuan në studimin e këtij aspekti të rëndësishëm të historisë së shqipes.

1) Karakter i indoevropian i shqipes dhe vendi i saj në rrethin e gjuhëve indoevropiane — Rezultateve të shënuara pas mendimeve të vyera të mendimtarëve të shekujve XVI-XVII-XVIII-XIX J. J. Skalliger, G. V. Laibnic, M. Brun, J. R. Ksilander, nga G. Shtir e F. Bopi në të mirë të përkatësisë së shqipes në familjen gjuhësore indoevropiane, e vazhduar kjo me sukses, sidomos nga albanologët G. Maier, H. Pedersen, N. Jokli, albanistika vendase e këtyre 25 vjetve u ka shtuar një sërë faktesh të reja, sidomos nga fusha e leksikut dhe e fjalëformimit të shqipes. «Studimet rreth etimologjisë së gjuhës shqipe», të botuara nga E. Cabej gjatë viteve 1960-1968, si edhe «Selectae» të botuara nga A. Xhuvani¹⁰, të bazuara në analizën e një materiali faktik mjaft të gjerë nga fusha e shqipes, janë një kontribut i shënuar, veç të tjerave, edhe në zbulimin e fondit autokton të leksikut të shqi-

9) M. Domi, *L'albanais et sa structure grammaticale*, në «Revue des études slaves», tome quarante-cinquième, 1966, f. 19-32.

10) E. Cabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, BUSHTSSHSH, 1960, 4, f. 9-102; 1961, 1, fq 60-102; 1961, 2, f. 47-78; 1961, 3, f. 53-72; 1961, 4, f. 106-133; 1962, 1, f. 83-120; 1962, 2, f. 225-232; 1962, 3, f. 49-76; 1963, 1, f. 110-129; 1963, 2, f. 127-153; 1963, 4, f. 83-97; SF, 1964, 1, f. 61-99; 1964, 2, f. 11-45; 1964, 3, f. 15-55; 1964, 4, f. 65-117; 1965, 1, f. 3-47; 1965, 2, f. 7-55; 1965, 3, f. 41-85; 1965, 4, f. 41-71; 1966, 1, f. 3-59; 1966, 2, f. 51-107; 1966, 3, f. 51-69; 1966, 4, f. 53-83; 1967, 1, f. 65-97; 1967, 2, f. 3-21; 1967, 3, f. 31-47; 1968, 1, 107-143, 1968, 3, f. 85-119. A. Xhuvani, *Selectae*, në «Studime gjuhësore», Tiranë 1965, f. 47-106.

pes, për pasojë, edhe të argumentimit të mëtejshëm të përkatësisë së saj në familjen gjuhësore indoevropiane.

Si trashigim indoevropian janë vështruar nga A. Xhuvani dhe E. Çabej, në pajtim edhe me N. Joklin e H. Pedersenin, edhe disa nga parashtesat e prapashtesat e gjuhës shqipe¹¹, ndonëse, sikundër theksojnë me të drejtë këta autorë, «disa nga këto formante të lashta kanë humbur e janë zëvendësuar me të huaja»¹².

Problemi se me cilën ose me cilat nga gjuhët motra indoevropiane shqipja ka një afërsi më të madhe, ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e gjuhëtarëve. Rezultatet e arritura në zbulimin e konkordancave të veçanta të shqipes me degën baltike të baltosllavishtes, si edhe me keltishten, gjuhët gjermanike, greqishten e armenishten i ka çuar disa përfaqësues të albanistikës së huaj në konkluzionin se shqipja qëndron ndërmjet armenishtes e sllavobaltishtes.

E. Çabej, duke bërë bilancin e rezultateve të arritura në trajtimin e këtij problemi si edhe duke u shtuar materialeve të sjella më parë edhe fakte të reja¹³, me të drejtë thekson se kjo çështje parimore nuk mund të merret si e sqaruar, sa kohë që sistemi i tingujve dhe i formave gramatikore të shqipes nga pikëpamja e burimit të tyre nuk janë studjuar plotësisht dhe sa kohë që barazimet pjesore që e lidhin këtë gjuhë me gjuhët e afërta me të, nuk janë përmbledhur statistikiisht në grupe.¹⁴ Ai, duke u nisur nga fakti që konkordancat që vihen re midis shqipes dhe gjuhëve të përmendura më sipër në asnjë drejtim nuk janë me aq rëndësi sa të vërtetojnë një periudhë zhvillimi të përbashkët të shqipes me ndonjerën prej këtyre gjuhëve, e gjen mjaft reale dhe më afër së vërtetës pikëpamjen e F. Bopit, i cili shkruante se gjuha shqipe «në elementet e saj themelore me asnjërën nga gjuhët motra sanskrite të kontinentit tonë nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë, ose aq më pak, ndonjë lidhje derivacioni, burimi»¹⁵.

Një kontribut është dhënë në zbulimin e konkordancave të reja kelto-shqiptare. Mbas një vështrimi kritik të rezultateve të arritura nga N. Jokli në zbulimin e konkordancave kelto-shqiptare në fushën e emrave të bimëve, të drurëve, të kafshëve shtëpiake, të dukurive klimaterike, të lidhjeve shoqërore, të farefnisës, të pjesëve të trupit, janë zbuluar edhe një sërë konkordancash të reja nga fusha e botanikës, relievit, shtazëve, ngjyrave dhe pjesëve të trupit. Është dhënë kështu një tablo më e plotë e më e qartë e këtyre konkordancave. Është vënë re gjithashtu se në këto konkordanca kelto-shqiptare nganjëherë merr pjesë edhe greqishtja, duke formuar kështu

11) A. Xhuvani — E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, BSHSH 1956, 4. f. 66-103; *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962.

12) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat...* f. 4.

13) E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë 1960, f. 9, 10 (dispensë); *Keltisch-albanische Isoglossen*, në «Studi linguistici in onore di Vittore Pisani», Paideia editrice Brescia, f. 167-186.

14) E. Çabej, *Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21 nëndor 1962)» Tiranë 1965, f. 90. Botuar edhe në BUSHT SSSH, 1962, 4. (Shih edhe botimin gjermanisht: E. Çabej, *Einige Grundprobleme der älteren albanischen Sprachgeschichte*, «Studia Albanica», 1964, 1; dhe botimin italisht: E. Çabej, *Di alcuni problemi di storia antica della lingua albanese*, në «Rassegna di studi albanesi», 1963, 1, Roma).

15) E. Çabej, *Disa probleme themelore...* f. 90.

izoglosa tripalëshe, greko-kelto-shqiptare, të cilat në ndonjë rast shtrihen edhe në fushën e morfologjisë.¹⁶

Lidhjet e shqipes me gjuhët motra indoevropiane janë vështruar si një nga rrugët kryesore për përcaktimin e djepit parabalkanik të shqiptarëve. Të mbështetur në lidhjet e ngushta të shqipes me disa gjuhë të Evropës Veriore (baltosllavishten, gjermanikishten, keltishten) e Lindore (armenishten si dhe në disa huazime të lashta që ka shqipja nga iranishtja dhe finougrishtja), E. Çabej, në pajtim edhe me G. Majerin e N. Joklin, ka pranuar pikëpamjen që e vendos djepin parabalkanik të shqiptarëve në një trevë të Evropës Verilindore¹⁷.

E. Çabej, duke u nisur nga fakti se shqipja është e vetmja gjuhë që mund të shpjegojë me mjetet e saj emrat e vargmaleve të Evropës Qendrore-lindore, Karpatet e Beskidet, arrin në konkluzionin se pellgu i Karpateve mund të ketë qenë një stacion në shtegëtimin e tyre për në Evropën Jugore¹⁸.

E quajmë me vend të shënojmë këtu se arkeologjia shqiptare, e mbështetur në të dhëna të reja të zbuluara në vendin tonë, ka pranuar tezën se djepi i vjetër i kulturës ilire është vetë Ballkani dhe kryesisht krahinat jugore të tij¹⁹, tezë kjo që bie në kundërshtim me tezën e gjuhëtarëve të formuluar më parë nga G. Majeri, të saktësuar më tej nga N. Jokli dhe të pranuar edhe nga E. Çabej e A. Desnickaja mbi djepin parabalkanik të shqiptarëve në Evropën Qendrore, në verilindje të saj.

2) Problemi i burimit të shqipes dhe i djepit të shqiptarëve në Ballkanin e vjetër — Problemi i burimit (bij të cilit popull janë shqiptarët dhe bijë e cilës gjuhë të vjetër të Ballkanit është shqipja?) ka qenë një nga problemet themelore jo vetëm të albanistikës së huaj të shekujve XIX-XX, por edhe të albanistikës vendase të këtyre 25 vjetve.

Krahas fakteve e argumentave të rinj, që janë sjellë nga albanistika vendase e këtyre 25 vjetve në favor të tezës ilire, janë bërë orvatje për të lidhur gjuhën shqipe me substratin etniko-gjuhësor pellazg nga S. Konda në veprën e tij «Shqiptarët dhe problemi pellazgjik»²⁰. Autori në këtë vepër nuk përfill në masën e duhur ligjet fonetike, që përbëjnë pikëmbështetjen e metodës krahasuese të përdorur prej tij. Vihen re çalime në zbatimin e kësaj metode edhe në fushën e morfologjisë e të semantikës. Një qëndrim jokonsekuent mbahet edhe ndaj dallimit të huazimeve nga fjalët e fondit autokton të shfrytëzuara për krahasim, gjë që e ka çuar autorin në interpretime të pasakta. Të gjitha këto i vënë mjaft në dyshim rezultatet e arritura në këtë vepër. Gjuhësia shqiptare e këtyre 25 vjetve, së bashku edhe me arkeologjinë e etnografinë shqiptare, me faktet dhe argumentat e reja që

16) E. Çabej, *Keltisch-albanische...*, f. 167-186.

17) E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë 1960, f. 8-10 (dispensë); *Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21 nëndor 1962)», Tiranë 1965, f. 90.

18) E. Çabej, *Disa probleme themelore...* f. 91.

19) S. Islami — H. Ceka, *Të dhëna të reja mbi lashtësinë ilire në territorin e Shqipërisë*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21 nëndor 1962)», Tiranë 1965, f. 441-456. F. Prendi, Diskutim rreth kumesës së S. Islamit e H. Cekës, *Po aty*, f. 635-639.

20) S. Konda, *Shqiptarët dhe problemi pellazgjik*, Tiranë 1961. Disa nga problemet themelore të kësaj vepre janë parashtruar edhe në kumesën *Albanët (shqiptarët) dhe problemi pellazgjik*, të lexuar prej tij në Konferencën e parë të studimeve albanologjike (shih «Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21 nëndor, 1962)», Tiranë 1965, f. 144-154).

kanë sjellë, kanë hedhur një dritë të re mbi etnogjenezën e popullit shqiptar, duke ju afruar gjithnjë e më shumë zgjidhjes së këtij problemi me interes jo vetëm për albanologjinë, por edhe për ballkanologjinë.

Një vlerë të veçantë kanë në këtë drejtim punimet «Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe» (III), «Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe» «Der Beitrag des Albanischen zum Balkansprachbund» (Kontributi i shqipes në lidhjen gjuhësore ballkanike), «Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve»²¹ të E. Cabejt, të cilat bashkojnë një të vetme rezultatet e arritura më parë me rezultatet e reja të autorit në favor të tezës ilire të burimit të shqipes. Në këto vepra problemi i burimit veshtrohet nga pikëpamja gjeografike, historike dhe nga pikëpamja gjuhësore.

Nga pikëpamja gjeografike dhe historike janë vlerësuar si faktorë pozitivë në favor të tezës ilire fakti që shqiptarët e sotëm banojnë aty ku në kohën e vjetër kanë qenë kryesisht fise ilire, si edhe fakti që në historinë e popullit tonë nuk ka ndonjë shenjë për një imigracion të mëvonshëm në këto anë.

Nga pikëpamja gjuhësore është vërtetuar se nga ato pak materiale që kemi nga ilirishtja, një pjesë e mirë e tyre gjejnë shpjegim nëpërmjet gjuhës shqipe. Konkordancat e vëna re më parë dhe të pasuruar me të dhëna të reja mes ilirishtes ballkanike dhe shqipes, mesapishtes dhe shqipes, mes disa fjalëve provinciale të latinishtes dhe shqipes, të cilat mendohet se rrjedhin prej ilirishtes së Italisë Jugore ose të Ballkanit, mes disa fjalëve pararomake të Alpeve dhe shqipes janë vlerësuar si argumenta bindës në favor të burimit ilir të shqipes.

Nga ana tjetër është bërë objekt i një vështrimi kritik teza trake e burimit të shqipës duke u theksuar se ajo, për arsye gjeografike, historike e gjuhësore qëndron më larg së vërtetës dhe, për këtë arsye, kërkon argumenta të veçanta për ta bërë të besuar.

Lidhje specifike ndërmjet shqipes dhe ilirishtes janë vënë re edhe në mënyrën e reflektimit të labiovelareve indoevropiane dhe në kronologjinë e zhvillimit të tyre nga J. Gjinari në punimin e tij «Mbi vazhdimësinë e ilirishtes në gjuhën shqipe»²².

Argumentave të sjellë në favor të tezës ilire u shtohen edhe fakte e argumenta të rinj në punimet «Ndër burime të fjalës së shkrueme të ilirishtes së periudhë e vjetër e historisë së gjuhës shqipe»²³ dhe në punimin «Rreth kronologjisë dhe burimit të kalimit të *û*-së indoevropiane dhe latine në *y* në shqipen»²⁴.

Problemi i djepit të shqiptarëve në Ballkanin e vjetër (autoktonia e tyre) ka qenë një nga më themeloret, me të cilin janë marrë mjaft gjuhëtarë të huaj, duke formuluar teza nga më kontradiktoret.

Gjuhësia shqiptare e këtyre 25 vjetve ka dhënë një kontribut të

21) E. Cabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUSHT, SSHSH, 1963, 3, f. 92-101; *Der Beitrag...*, punim i cituar; *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*, BUSHT SSHSH, 1958, 2, f. 54-67.

22) J. Gjinari, *Mbi vazhdimësinë e ilirishtes në gjuhën shqipe*, SF, 1969, 1, f. 71-81.

23) K. Ashta, *Nder burime të fjalës së shkrueme të ilirishtes si periudhë e vjetër e historisë së gjuhës shqipe*, «Buletin shkencor i Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës», 1966, 5, 181-209.

24) B. Beci, *Rreth kronologjisë dhe burimit të kalimit të u-së indoevropiane dhe latine në shqipen*, «Buletin shkencor i Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës», 1966, 5, f. 221-222.

veçantë, nga njëra anë, në kapërcimin e «arësyeve gjuhësore» të sjella prej G. Vaigandit në favor të pikëpamjes së tij mbi shtegëtimin e shqiptarëve prej visesh më lindore në viset perëndimore pranë Adriatikut aty nga mbarimi i kohës antike ose në mesjetën e parë dhe, nga ana tjetër, ka sjellë një sërë argumentash të reja në favor të autoktonisë së shqiptarëve.

Mendimi i Vaigandit që emrat latinë të vendeve si *Valbona, Domni, Patosa, Surella, Kapra, Oblika, Petrosa, Durmitor e Visitor* nuk paraqiten me trajtën shqiptare po me trajtën latino-dalmate, si edhe mendimi tjetër që, po të kishin banuar shqiptarët gjithmonë në Shqipërinë e sotme, emrat e vendeve që burojnë prej kohës antike, duhet të kishin kryer zhvillimin fonetik të shqipes, gjë që simbas Vaigandit nuk vërtetohet, me argumentat bindës të sjellë nga gjuhësia shqiptare mund të konsiderohen të kapërcyera²⁵. Është vërtetuar në mënyrë bindëse se toponimet antike të vendit tonë me formën e sotme të tyre dëshmojnë për vazhdimësi shqiptare. Format e sotme: *Shar, Shkup, Shkodër, Lesh, Drisht, Durrës, Kunavljë, Drin, Buenë, Mat, Ishëm, Çam* që u përgjigjen formave antike: *Scardus, Scupi, Scodra, Lisus, Drivastum, Dyrrachium, Candavia, Drinus, Barbanna, Mathis, Ysarnus, Thyamis* janë shpjeguar vetëm me anë të shqipes, sepse ato ruajnë tiparet specifike të zhvillimit të saj²⁶.

Vaigandi pohonte gjithashtu se shqiptarët «po të kishin banuar gjithmonë në Iliri, duhet të kishin ruajtur disa nga më të zakonshmet terma të leksikut autokton të trashëguar si ndonjë fjalë për lundër, anije, lopatë, timon, shul, vel si edhe emra peshqish etj.». Edhe kjo pikëpamje me rezultatet e arritura nga gjuhësia shqiptare në këtë pikë duhet konsideruar si e vjetëruar. E. Çabej, duke mos mohuar se leksiku detar i shqipes së sotme në pjesën e tij më të madhe është i huaj, sidomos termat teknike të lundrimit e të peshkatarisë, ka provuar, nga ana tjetër, se një pjesë e mirë e fjalëve nga kjo fushë janë të fndit autokton (*dët, bregdet, detar, denik, va, mat, grykë, valë, shkullm, ujë amull, ani, anije, gripareas, ballës, verzna, pëlhurë, shul, zugatë, shtizë, likurishtë, ngjalë, balluk, barkgjerë etj.*)²⁷.

L. Dodbiba ka mbrojtur mendimin se ekzistenca e një leksiku detar me tipare të përbashkëta mesdhetare dhe pjesëmarrja e shqipes në këtë «koine» mesdhetare është një provë në favor të autoktonisë. Simbas tij, po të kishte shqipja një terminologji krejt të vetën «ad usum proprium», kjo do të ishte një provë se shqiptarët nuk janë autoktonë në viset ku banojnë sot dhe se kanë hyrë vonë në marrëdhënie me popujt e tjerë të Mesdheut.²⁸

L. Dodbiba ka plotësuar listën e fjalëve të pahuazuara të leksikut detar të shqipes të sferës së detit, të gjeomorfologjisë bregdetare, të

25) E. Çabej, *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve*, BUSHT SSSH, 1962, 1, f. 220 (shih edhe botimin gjermanisht, E. Çabej, *Die älteren Wohnsitze der Albaner auf der Balkanhalbinsel im Lichte der Sprache und der Ortsnamen*, në «VII Congresso Internazionale di Scienze Onomastiche», Firenze — Pisa, 4-8 aprile 1961, f. 241-251.

26) E. Çabej, *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*, BUSHT SSSH, 1958, 2, 54-62; *Vendbanimi i hershëm...*, f. 220-223.

27) E. Çabej, *Vendbanimi i hershëm...*, f. 223-224.

28) L. Dodbiba, *Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e tij të pahuazuara*, SF, 1967, 1, f. 39 (shih edhe variantin frengjisht në «Studia Albanica», 1966, 2, f. 63-85).

mjeteve të lundrimit dhe të manovrave detare, të peshkimit, të iktionimisë dhe faunës detare, si edhe të meteorologjisë.

Janë sjellë edhe të tjera dëshmi që vërtetojnë autoktoninë e shqiptarëve, siç janë marrëdhënjet e hershme të shqipes me greqishten, latinishten e dalmatishten.

Huazimet latine me karakterin e tyre shumë arkaik tregojnë, si mbas Çabejt, që depërtimi i tyre në gjuhën shqipe, i përket një periudhe më të vjetër të saj, e cila është më e vjetër se romanizimi i dakishtes, gjë që flet kundër një ardhjeje të shqiptarëve nga trevat lindore të Ballkanit.²⁹

Është konsideruar e pa drejtë edhe pikëpamja e Shtadmylerit i cili e vendos djepin e shqiptarëve në një trevë relativisht të vogël të Shqipërisë Veriore. Argumentat e parashtruar dhe të tjerë, që s'u përmenden këtu, po që kanë gjetur një shtjellim të veçantë në punimet e cituara, e kanë çuar gjuhësinë shqiptare në këtë konkluzion: «vendbanimi i sotëm i shqiptarëve nuk është një trevë ekspansioni, po një trevë restriksioni, përfundim i një ngushtimi të paparë gjatë historisë shqiptare.»³⁰.

Si një tezë e pambështetur historikisht dhe gjuhësisht është konsideruar edhe teza e V. Georgievit mbi burimin e shqipes nga dako-myzishtja³¹.

3. Lidhjet e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit në periudhën historike. — Gjuhësia shqiptare e këtyre 25 vjetve ka dhënë një kontribut të vlefshëm në zbulimin e sqarimin e karakterit të lidhjeve gjuhësore ballkanike, jo vetëm me materialet e reja që ka vënë në dispozicion të studimeve nga gjuha e sotme letrare kombëtare dhe nga dialektet, po edhe me qëndrimin objektiv dhe të argumentuar në zgjidhjen e disa prej problemeve themelore që kanë dalë përpara saj.

Përpara se të ndalemi në kontributin e gjuhësisë shqiptare të këtyre 25 vjetve në trajtimin e lidhjeve të shqipes me secilën nga gjuhët e Ballkanit, me një, dy ose me shumë prej tyre, po lejohemi të përmendim punimet me një karakter më të përgjithshëm në këtë fushë. Këto janë: «Das Albanische und seine Nachbarsprachen» (Shqipja dhe gjuhët fqinjë me të)³², «Der Beitrag des Albanischen zum Balkansprachbund» (Kontributi i shqipes në lidhjen gjuhësore ballkanike)³³.

Në këta artikuj ngrihet me të drejtë domosdoshmëria e vështrimit të këtij problemi në dyanshmërinë e tij, nga pikëpamja e ndikimit të këtyre gjuhëve në gjuhën shqipe dhe nga pikëpamja e ndikimit të shqipes në këto gjuhë. Duke u udhëhequr nga ky parim themelor gjuhësia shqiptare ka dhënë një pasqyrë objektivisht më të plotë të vijave themelore të këtyre lidhjeve.

Në këta artikuj vihet në dukje që shqipja ka luajtur një rol të veçantë në formimin e afërsisë gjuhësore ballkanike për këto arsye:

1) shqipja është një nga gjuhët më të lashta të formuara më herët në

29) E. Çabej, *Der Beitrag des Albanischen zum Balkansprachbund*, «Studia Albanica», 1967, 1, f. 50. (Shih edhe «Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes», Sofia 1968, f. 44).

30) E. Çabej, *Problemi i autoktonisë...* f. 58.

31) Sh. Demiraj, *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe*, SF, 1969, 1, f. 86-87; J. Gjinari, *Mbi vazhdimësinë e ilirishtes në gjuhën shqipe*, SF, 1969, 1, f. 72-73.

32) E. Çabej, *Das Albanische und seine Nachbarsprachen*, në «Die Sprache», XIII. Band 1. Heft. 1967. f. 39-51.

33) E. Çabej, *Punim i cituar*.

Gadishullin Ballkanik, e cila ka pasë shkëmbime shumëshekullore me gjuhët fqinjë: 2) trualli i shqipes ka qenë më i madh nga ç'është sot; 3) shtegëtimet dhe ngulimet e një pjese të popullit shqiptar në viset fqinjë kanë bërë që të çojnë atje elemente të gjuhës dhe të toponomastikës.

Një përpjekje të re pozitive me rezultate konkrete në zbulimin e paraleleve frazeologjike (togfjalëshat e qendrueshëm frazeologjikë që janë ngjizur historikisht dhe që funksionalisht janë ekuivalentë me njësi të vetme leksikore) të gjuhëve ballkanike përbën punimi i J. Thomajt e Xh. Lloshit, «Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit», të para si paralele tipash, llojesh, kategorish në strukturën e tyre formale dhe në ndërtimin semantik të tyre³⁴.

a. Marrëdhënjet e shqipes me greqishten e vjetër në periudhën historike. — Mungon deri më sot një punim i veçantë që ta rrokë problemin e ndikimit reciprok të këtyre dy gjuhëve me tërësinë e tij.

Siç është vënë në dukje, ky problem është më i rëndësishëm jo vetëm për historinë e shqipes, po edhe për historinë e vetë greqishtes, sepse mënyra e reflektimit të tingujve të greqishtes së vjetër në shqipe lejon të zbulohet vlera e tyre në greqishten e vjetër.

Ky problem është bërë objekt trajtimi në punimet «Das Albanische und seine Nachbarsprachen», «Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe», «Der Beitrag des Albanischen zum Balkan sprachbund».

E. Çabej, duke përmbledhur rezultatet e mëparshme me të tija, arrin në përfundimin që ky ndikim është më i madh në sasi dhe më i hapët nga pikëpamja e shtrirjes territoriale se ç'ishte menduar më parë. Ai, përveç sferës së bimëve të mirëfillta (barishte dhe pemë), përfshin edhe sferën e drurëve, të veglave, të enëve, të armëve, të gjellëve, të shtazëve, të truallit, të detarisë dhe të besimit³⁵.

Pranë këtij grupi huazimesh nga greqishtja e vjetër është vënë një grup tjetër fjalësh (bretëk, lëpjetë, mëllagë), të cilat nuk mund të thuhet se rrjedhin me siguri nga greqishtja e vjetër. Ato, simbas tij, janë më fort të një burimi paraindoevropian mesdhetar. Është dalluar edhe një grup i tretë (*djall*, *maraj*), për të cilin ekziston një mundësi e barabartë që të jetë marrë drejtpërdrejt prej greqishtes së vjetër ose nëpërmjet latinishtes. Për fjalë si *hir*, *pëllëmbë*, *shtyllë* etj., me gjen-djen e sotme të studimeve, nuk mund të thuhet në se rrjedhin nga greqishtja e vjetër ose e mesme-bizantine.

Është ngritur gjithashtu edhe nevoja e një periodizimi të ndikimeve të greqishtes së vjetër në dy grupe: 1) në ndikime nga greqishtja e vjetër e lashtë dhe 2) në ndikime nga greqishtja e vjetër e vonë³⁶.

Është mbrojtur mendimi që ky ndikim buron kryesisht prej kolonive dorike në bregdetin shqiptar, prej dialekteve veriperëndimore greke dhe prej botës dorike të Magna Graecias³⁷. Janë evidencuar edhe disa nga faktet që vërtetojnë ndikimin e dorishtes në shqipe, pa u ndalur në trajtimin e gjerë të këtij problemi.

34) J. Thomaj — Xh. Lloshi, *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit*, SF, 1967, 1, f. 97-113 (Shih edhe variantin frengjisht në «Studia Albanica», 1966, 2, f. 161-175).

35) E. Çabej, *Disa probleme themelore...*, f. 102-104.

36) E. Çabej, *Po aty*, f. 104; *Das Albanischen...*, f. 44-45.

37) E. Çabej, *Hyrje në historinë...*, f. 42; *Disa probleme themelore...*, f. 105; *Das Albanische...*, f. 45.

Nga gjuhësia shqiptare janë sjellë edhe një numër jo i parëndësishëm fjalësh që përligjin mendimin e parashtruar edhe më parë nga një sërë dijetarësh mbi ndikimin e një shkalle më të vjetër të shqipes në greqishten e vjetër³⁸.

Është vënë re gjithashtu se ndikimi i shqipes në greqishten e re në përgjithësi ose në pjesën veriore të saj është më i madh nga sa pohonte Majeri. Ndikime të shqipes janë vënë re edhe në të folmet e fshehta të zejtarëve, sidomos të krahinave veriore të saj³⁹.

b. Marrëdhënjet e shqipes me latinishten ballkanike. Problemit të marrëdhënjeve të shqipes me latinishten ballkanike i është kushtuar studimi i «Zur Charakteristik der lateinischen Lehnwörter im Albanischen»⁴⁰, i E. Çabejt. Problemi është trajtuar në mënyrë të përmbledhur edhe në disa artikuj të tjerë⁴¹.

Në këto punime jepet një kuadër i shtrirjes së ndikimit të latinishtes në hapësirë dhe në kohë. Vihet në dyshim mendimi i atyre dijetarëve që, duke u nisur nga mbishkrimet, kërkonin të vendosnin një kufi të prerë midis zonave që ishin romanizuar dhe atyre që ishin helenizuar. Për Ballkanin e vjetër, pohohet në këta artikuj, më shumë se për kufi gjuhësh duhet folur për kufi kulturash, meqenëse fshatarësia për shumë kohë, në anë të ndryshme, nuk foli as latinisht, as greqisht, gjë që dëshmohet me ruajtjen e gjuhës shqipe e të besëve trakas gjer në shekullin e VI të erës sonë.

Elementët latine të shqipes, simbas këtyre artikujve, zënë një vend të mesëm midis latinitetit ballkanik kontinental, përfaqësuar me rumanishten dhe latinitetin bregdetar, përfaqësuar me dalmatishten, ndonëse kjo e fundit dhe lidhjet e shqipes me të njihen jo në mënyrë të plotë.

Fakti që ndikimi i latinishtes ka vazhduar në shqipen 700 vjet, ka diktuar nevojën e një periodizimi të huazimeve latine. E. Çabej, nga të gjitha ato që janë sjellë si dëshmi për të vërtetuar ekzistencën e dy shtresave ndikimesh latine gjeografikisht dhe gjuhësisht të ndryshme të shqipes, pranon vetëm ndonjerën prej tyre.

Dëhen përpjekje për të përcaktuar pozitën e huazimeve latine të shqipes në rrethin e gjuhëve romane dhe arrihet në konkluzionin se ata përbëjnë një hallkë lidhëse midis gjuhëve romane lindore dhe atyre perëndimore.

Janë bërë gjithashtu objekt i një vështrimi të krahasuar edhe elementet latine të shqipes e të rumanishtes dhe është arritur në përfundimin se duhen rishikuar rezultatet e arritura deri tani lidhur me ato që kujtohen si latinitet ballkanik.

Është dhënë një kontribut i madh në veçimin e mëtejshëm të fjalëve latine në shqipe nga fjalët e fondit indoevropian të saj, nga fjalët e substratit paraindoevropian të Mesdheut si edhe nga fjalët italiane, dalmate e rumune. Në këtë mënyrë gjuhësia shqiptare ka provuar me argumenta bindës se diçka e mëparshme i ka zmadhuar dimensionet e ndikimit latin.

Janë bërë përpjekje edhe në përcaktimin e fjalëve që kanë hyrë

38) E. Çabej, *Disa probleme themelore...*, f. 100-101; *Der Beitrag...*, f. 49.

39) E. Çabej, *Das Albanische...*, f. 46; *Der Beitrag...*, f. 48.

40) E. Çabej, *Zur Charakteristik der Lateinischen Lehnwörter im Albanischen*, në *Revue de Linguistique*. T. VII. 1962. 1, f. 161-199.

41) E. Çabej, *Disa probleme themelore...*, f. 106-107; *Der Beitrag...*, f. 45-46; *Das Albanische...*, f. 47-49.

direkt nga latinishtja, dhe të atyre që kanë hyrë me ndërmjetësinë e greqishtes. Gjithashtu, duke u nisur nga veçoritë fonetike (sidomos nga theksi i fjalës), është arritur të vërtëtohet, që disa fjalë greke janë futur në shqipen me ndërmjetësinë e latinishtes.

Gjuhësia shqiptare, e bazuar në një material gjuhësor më të pasur nga fusha e shqipes, ja ka dalë me sukses, duke vijuar punën e filluar nga G. Majer, H. Pedersen, K. Sandfeld, V. Majer — Lybke dhe N. Jokli, të japë një pasqyrë objektivist më të saktë të elementeve latine në shqipe. Është përqëndruar vëmendja edhe në anën tjetër të problemit; ajo, fakteve të sjella nga N. Jokli, që flasin për ekzistencën e elementeve të shqipes së vjetër në latinishten, u ka shtuar të dhëna të reja, duke theksuar që nuk është e qartë në se këto fjalë janë futur në latinishten në Gadishullin Ballkanik ose në Italinë e Poshtme.

c. Marrëdhënjet e shqipes në rumanishten — Prej kohësh dijetarë të ndryshëm kanë vënë re se shqipja e rumanishtja kanë mjaft gjëra të përbashkëta në sistemin fonetik, në leksik e fjalëformim, në morfologji e sintaksë, si edhe në frazeologji. Këto bashkëpërkime janë vënë re si në elementin latin, ashtu edhe në elementin jolatin të tyre.

Pikërisht problemit të shpjegimit të burimit të elementeve të përbashkëta jolatine të këtyre dy gjuhëve gjuhësia shqiptare e këtyre 25 vjetve i ka kushtuar vëmendje më të veçantë, duke sjellë argumenta të rinj bindës në favor të pikëpamjes së shprehur prej N. Joklit, sipas së cilës një numër i konsiderueshëm i këtyre fjalëve në shqipe nuk qëndron i izoluar ose pa interpretim etimologjik, po hyn e zë vend në sistemin gjuhësor të saj.

Është vënë re se rreth 100 fjalë janë të përbashkëta për shqipen e rumanishten.

Gjuhësia shqiptare, duke u nisur nga parimi i vendosur prej Raskut: «kur e njëjta fjalë gjendet në shumë gjuhë, duhet të mendojmë që ajo i përket asaj gjuhe, në të cilën na shfaqet me një kuptim sa më të domosdoshëm material e të përgjithshëm»: «kur një fjalë në një gjuhë shfaqet e izoluar, pa ndonjë lidhje të dukshme dhe pa rrjedhja (derivate) ose me fare pak të këtilla në një tjetër gjuhë përkundrazi me lidhje të qarta... ose me një varg të tërë rrjedhojash dhe në këtë mënyrë krejt e ndërthurur përbrenda gjuhës, atëhere mund të nxjerrim përfundimin që kjo fjalë ka shtegëtur nga kjo gjuhë e dytë tek e para». [ka konstatuar (1) që këto çifte fjalësh në shqipe kanë pjesërisht farefisën e tyre; (2) për disa vërtëtohet një trajtë tjetër, më e vjetër, prej nga del vetvetiu karakteri sekondar i formës që është në bazë të rumanishtes (3) në shqipe është ruajtur një shkallë më e vjetër ose më konkrete e kuptimit të tyre; (4) disa nga trajtat e këtyre fjalëve në gjuhët fqinjë janë sekondare nga pikëpamja e fonetikës historike të shqipes; (5) për disa nga këto fjalë ekziston mundësia e një shpjegimi etimologjik të rregullt në pajtim me ligjet fonetike të shqipes⁴².

Të gjitha këto kanë shërbyer si dëshmi në favor të burimit shqiptar të këtyre fjalëve të përbashkëta.

Në shqipe dhe rumanishte janë vënë re konkordanca edhe në

42) Për këto pikëpamje dhe disa të tjera që kanë të bëjnë me problemin e lidhjeve të shqipes me rumanishten, shih E. Çabej, *Betrachtungen über die Rumänisch-Albanischen Sprachbeziehungen*, «Revue Roumaine de Linguistique», Tom X, 1965, 1, f. 101-115; *Der Beitrag...*, f. 49-51.

ndërrimin e gjinisë së emrave në shumës⁴³. Në të dyja këto gjuhë fenomeni është vërejtur vetëm tek emrat që emërtojnë jofrymorë. Është mbrojtur mendimi se ky fenomen në shqipe, duhet të ketë lindur edhe të jetë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga i njëjti fenomen në rumanishte. Argumentat e sjellë përjashtojnë mundësinë që ky fenomen të ketë lindur nën ndikimin e substratit trak ose nën ndikimin e latinishtes.

Një tog konkordancash të plota ose të pjesshme janë vënë re në sintaksën e frazës me fjali të varura⁴⁴, në konstruktet tautologjike⁴⁵, si edhe në përsëritjen si mjet gramatikor të shprehjes së aspektit dhe të shkallës sipërore në aspektin formal dhe në vlerat kuptimore të saj⁴⁶.

ç) Marrëdhënjet e shqipes me sllavishten — Problemi i marrëdhënjeve shqiptaro-sllave nuk është bërë objekt i ndonjë studimi të veçantë tek ne. Megjithatë, për probleme të veçanta të marrëdhënjeve të këtyre gjuhëve në aspektin marrës dhe dhënës të tyre janë dhënë mendime në punime që nuk janë marrë ekskluzivisht me këtë problem⁴⁷.

Elementeve sllave në fushën e fonetikës dhe të fjalëformimit në grupin e të folmeve të dialektit jugor, që shtrihen ndërmjet Vjosës dhe Shkumbinit, i është kushtuar punimi «Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore» i J. Gjinarit. Autori konstaton se në fushën e fonetikës këto ndikime janë të pakta dhe nga pikëpamja e përhapjes territoriale të kufizuara. Struktura morfologjike nuk është prekur fare prej ndikimit të sllavishtes, kurse në fushën e fjalëformimit ato janë më të shumta dhe me një përhapje territoriale më të madhe. Numri më i madh i tyre konstatohet në zonat lindore, sidomos në krahinat kufitare, gjë që tregon, simbas autorit, se përhapja e tyre në viset perëndimore të këtij territori është bërë nën ndikimin e këtyre zonave.⁴⁸

Përveç këtyre është konstatuar se disa fjalë si *baltë*, *daltë*, *druvar*,

43) Sh. Demiraj, *Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në gjuhën shqipe, vështruar edhe në përfaqje me rumanishten*, SF, 1966, 4, 83-99; (shih dhe variantin frengjisht: Sh. Demiraj, *A propos du changement de genre du pluriel dans l'albanais, confronte aussi avec le roumain*, në «Studia Albanica», 1966, 2, f. 97-113 dhe në «Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes», VI, Sofia, 1968, f. 371-384.

44) M. Domi, *Concordances et analogies syntaxiques albano-roumaines*, në «Studia Albanica», 1966, 2, f. 145-161; dhe në «Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes», VI, Sofia, 1968, f. 681-697.

45) S. Floqi, *Konstrukte tautologjike në shqipen e sotme (dhe paralele shqip-rumanisht)* SF, 1968, 3, f. 3-61 (shih edhe variantin frengjisht: *Constructions tautologiques en albanais contemporain (et concordances et divergences albano-roumaines)*, në «Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes», VI, Sofia, 1968, f. 293-305 dhe në «Studia Albanica», 1966, 2, f. 129-145.

46) E. Lafe, *Përsëritja si mjet gramatikor i shprehjes së aspektit dhe shkallës sipërore në gjuhën shqipe e parë edhe në krahasim me rumanishten*, SF, 1966, 4, f. 119-137 (shih edhe variantin frengjisht në «Studia Albanica», 1966, 2, f. 113-129 dhe në «Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes», VI, Sofia 1968, f. 841-855.

47) E. Çabej, *Hyrje në historinë...*, f. 57-62, 72-73; B. Beci, *Rreth kronologjisë dhe shkaqeve historike, që kanë përçaktuar kalimin e y-së në i në Gegëri të Mesme*, «Kongresi i Manastirit», Shkodër 1969, f. 57-65.

48) J. Gjinari, *Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë jugore*, SF, 1966, 4, f. 157-167.

gardh, lag, vranët, të cilat janë shikuar si sllave, janë në të vërtetë të fondit autokton⁴⁹.

Problemi i ndikimit të shqipes në gjuhët sllave, me gjithë interesin që paraqet, ka qenë në periferinë e interesave tona shkencore.

Është mbrojtur pikëpamja që duhen dalluar dy shtresa të elementeve të shqipes në gjuhët sllave; një shtresë më e vjetër dhe gjeografikisht më e përhapur dhe një shtresë më e re dhe më pak e përhapur. Fjalët e shtresës së parë janë përhapur, përveç se në gjuhët sllave të Ballkanit, edhe në rumanishten e me anë të saj edhe në disa vise të Evropës jashtë Ballkanit. Fjalët e shtresës së dytë kanë hyrë në serbokroatishten e bullgarishten, sidomos në ato dialekte që gjenden afër truallit të shqipes.⁵⁰

d. Marrëdhënjet e shqipes me turqishten — Kërkimet në këtë fushë kanë shkuar në dy drejtime themelore: (1) në drejtim të zbulimit të huazimeve të turqishtes në shqipe; (2) në drejtim të shtresëzimit kronologjik të këtyre huazimeve. Zbulimit të huazimeve të turqishtes në shqipe i kushtohet punimi i gjërë i T. Dizdarit «Huazime orientalizmesh në shqipe», botuar gjatë viteve 1960-1966⁵¹. Shtresëzimi kronologjik i turqizimeve shtjellohet në punimet «Hymja e turqizimeve në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre» si edhe në kumtesën «Bref aperçu des emprunts turcs à l'albanais» të A. Krajnit⁵². Autori i këtyre punimeve, duke u nisur nga ritmet dhe vëllimi i përhapjes së turqizimeve, dallon dy periudha: një periudhë të parë (XVI-XVII), në të cilën vëllimi i turqizimeve të futura qe i vogël dhe një periudhë të dytë (XVIII-XIX), në të cilën vëllimi i turqizimeve të futura në shqipe qe relativisht më i madh.

Është vënë re se ndikimi i turqishtes ka rrokur gjithë jetën qytetare. Më të dobëta janë gjurmët e këtij ndikimi në fshat. Me këtë është shpjeguar edhe fakti që janë të pakta ndikimet në fushën e blegtorisë e të bujqësisë, në emra të bimëve e të shtazëve⁵³.

II

Zbulimi i elementeve të sistemit fonetik e morfologjik të shqipes si edhe i ligjeve që kanë vepruar në periudhat e ndryshme të zhvillimit të saj, sidomos në periudhën e saj të re (shek. XVI e këtej), ka qenë në qendër të vëmendjes në kërkimet për historinë e gjuhës shqipe. Problemet themelore që janë trajtuar, janë këto: (1) zbulimi i ligjeve që kanë vepruar në reflektimin e tingujve dhe të strukturës morfologjike të indoevropianishtes në gjuhën shqipe; (2) zbulimi i tipareve të shqipes së periudhës paraletare, kryesisht mesjetare (para shek.

49) E. Çabej, *Der Beitrag...*, f. 47.

50) E. Çabej, *Hyrje në historinë...*, f. 72; *Das Albanische...*, f. 49-50; *Der Beitrag...*, f. 49-50.

51) T. Dizdari, *Huazime orientalizmesh në shqipet*, BUSHT SSSH, 1960, 2, f. 239-263; 1961, 1, f. 181-200; 1961, 4, f. 160-177; 1962, 1, f. 161-180; SF, 1965, 1, f. 47-79; 1965, 3, f. 85-100; 1966, 1, f. 121-139.

52) A. Krajni, *Hymja e turqizimeve në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre*, SF, 1965, 1, f. 143-151; *Bref aperçu des emprunts turcs à l'albanais*, në «Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes», VI, Sofia, 1968, f. 873-887 dhe në «Studia Albanica», 1966, 2, f. 85-97. Ky problem trajtohet edhe nga E. Çabej në kapitullin *Huazime turke të dispencës Hyrje në historinë...*, f. 62-68.

53) E. Çabej, *Hyrje në historinë...* f. 65.

XVI); (3) zbulimi i evolucioneve fonetike e morfologjike të shqipes së periudhës së re (letrare) (sh. XVI-XVIII).

Nga këto kanë tërhequr më shumë vëmendjen dhe janë trajtuar e argumentuar më gjerësisht evolucionet fonetike e morfologjike të shqipes së periudhës së re (letrare).

(1) Janë bërë përpjekje dhe janë arritur rezultate të reja nëpërmjet metodës krahasuese në përcaktimin e ligjeve që kanë vepruar në reflektimin e tingujve dhe të strukturës morfologjike të indoevropianishtes në gjuhën shqipe.

Duhet shënuar se në këtë fushë gjuhësia shqiptare në përgjithësi ka miratuar rezultatet kryesore, pozitive të arritura më parë nga albanologët e huaj, edhe në disa pika ajo i ka saktësuar e çuar më tej këto rezultate, ka rrezuar mjaft hipoteza të vjetra dhe ka formuluar teza të reja shkencërisht më të qëndrueshme.

Është mbrojtur mendimi që burimi i gjatësisë së zanoreve të gjuhës shqipe nuk duhet kërkuar gjithaq tek theksimi i saj ose tek vendi që ajo ka brenda fjalës, po më fort në faktin që ajo është vazhdim i një gjatësie origjinale. Është konstatuar, me gjithë rrafshimet që janë vënë re për shkak të veprimt të fenomenit të analogjisë, se shqipja ka ruajtur gjatësitë e vjetra, ose që janë përfutur nga kontraktimi i disa tingujve⁵⁴. Në kundërshtim me dijen e deritanishme është mbrojtur mendimi se kalimi i *ū*-së indoevropiane ose latine në *y* në shqipe është bërë në mënyrë të pandërmjetme dhe i përket një periudhe të lashtë të shqipes (para sh. IV të e. re)⁵⁵.

Me argumenta bindës, është vërtetuar se *j*-ja i. e., përveç *gj*-së jep në shqipe edhe *z* dhe është rrezuar mendimi i G. Majerit, i cili i njihte shqipes përveç reflektimit në *gj* edhe një reflektim në *j*⁵⁶.

Mendimi i G. Majerit se «Grupi fonetik *nd* — ruhet. Në fund të fjalës është ndërruar në *-nt*. Në trup të fjalës përkundrazi edhe *-nt* është kthyer në *nd*», është konsideruar i gabuar dhe është zëvendësuar me regullat që pasojnë: (1) *nd*, *-ng* intervokaliqe e lashtë, pavarësisht nga theksi, nëpërmjet një trajte *-nn*-ka dhënë *n* në kohën përpara periudhës romake të shqipes; (2) *nd*, *ng* e gjuhës së sotme, në çdo pozicion që të jenë, janë sekondare; ato mund të jenë refleksi i grupeve të vjetra *nt*, *nk*, i grupeve *nd*, *ng* të latinishtes, nga epenteza e një *n*-je përpara *d*-së ose *g*-së, si edhe nga shtesa e një *d*-je pas *n*-së ose *nn*-së.⁵⁷

E. Çabej ka konstatuar se kalimi i *nt*-së, *nk*-së respektivisht në *nd*, *ng* vihet re jo vetëm te fjalët e trashëguara të shqipes por edhe të huazimet latine, sllave, italiane si edhe tek ndonjë fjalë e bazuar nga turqishtja, gjë që tregon se ky fenomen ka qenë në fuqi edhe në kohën turke. Duke u nisur nga këto fakte, ai mbron pikëpamjen se aty nga mbarimi i mesjetës dhe në fillim të kohës së re sonorizimi i *t*-së e *k*-së pas një *n*-je nuk ishte kryer plotësisht⁵⁸.

54) E. Çabej, *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, BUSHT SShSh, 1957, 2, f. 207-213. Për këtë shih edhe E. Çabej, *Gjon Buzuku*, BShSh, 1955, 2, f. 84-85.

55) B. Beci, *Rreth kronologjisë...* f. 209-221.

56) E. Çabej, *Përmbi disa fjalë të shqipes që nisin me z*, BSHSH, 1952, 3, f. 37 (botuar dhe gjermanisht «Über einige mit z — anlauten — de Wörter des Albanischen», në «Zeitschrift für Phonetik u. allgem. Sprachwissenschaft», 9, Jahrgang, Heft 3, 1956, f. 203-229).

57) E. Çabej, *Grupet nd, ng në gjuhën shqipe*, BSHSH, 1953, 4, f. 30-37.

58) E. Çabej, *Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe*, BUSHT SShSh, 1958, 1, f. 41-43.

Është hedhur poshtë mendimi i S. Manit, sipas të cilit *rn*, *rj*, *rs*, *rm* indoevropiane kanë dhënë në shqipe *rr*, dhe është mbrojtur mendimi që nga këto të katra vetëm $[rn > rr]$. Është shtuar gjithashtu në pajtim edhe me dijetarë të tjerë se ka edhe dy burime të tjera nga mund të rrjedhë *rr* e shqipes: 1) me anë të rrçimit të *r*-së së shqipes në fillim të fjalës; 2) nga një *r* e thjeshtë në trup dhe në fund të fjalës me anë të një gaminacioni ekspresiv⁵⁹.

Është hedhur poshtë me argumenta bindës mendimi i G. Majerit, i cili i njihte shqipes një refleks të dyfishtë të palataleve indoevropiane ($*k' > s, th$; $*g' > z, dh$ ose *d*), dhe është miratuar mendimi i Pedersenit, që ato kanë dhënë vetëm spirante interdentalë ($*k' > th$; $*g > dh$ (*d*)).⁶⁰

Nëpërmjet përqasjes së formave gramatikore të shqipes me format gramatikore të gjuhëve indoevropiane të dëshmuara më herët është pranuar, në pajtim edhe me albanologët e huaj, se në shqipe kanë humbur mjaft formantë e kategori gramatikore të indoevropianishtes dhe disa të tjera janë rrafshuar me anë të analogjisë.

Një kontribut i veçantë është dhënë në ndriçimin e origjinës së mbaresave *-ë*, *-e*, *-a* të shumësit të asnjansëve, të mashkullorëve e femërorëve. Në pajtim me E. Çabejn, Sh. Demiraj ka pranuar që *ë*-ja e shumësit *veshë* e ka origjinën tek mbaresa *ā* e asnjansëve shumë të temave më *-o-* të indoevropianishtes.⁶¹ Si refleks i mbaresës *ā* të shumësit asnjansë indoevropian është interpretuar edhe mbaresa *-ë* e shumësit të emrave *vjet-ë*, *shenj-ë*, geg. *kren-ë*, tosk. *krer-ë*, shqip. *frer-ë*, *brir-ë*. *Ë*-ja e shumësit të emrave femërorë të tipit *punë* është shikuar si refleks i $*ās$ nga $*āes$ të emërores shumë, ose i $*ās$ nga $-ans$ të kallëzores shumë të emrave me temë në $-ā$ ose i të *dyjave* së bashku.⁶² *Ë*-ja e shumësit të emrave mashkullorë të tipit *gur-ë* është shikuar ose si analogjike me shumësin e asnjansëve ose edhe si refleks i $*ons$ (nëpërmjet këtij evolucioni: $*ons > *ans > *ās > *a > *ā > -ë$) të kallëzores shumë të emrave mashkullorë me temë në $-o$.⁶³

Është konsideruar i pambrojtshëm mendimi i Pedersenit e i Joklit që mbaresa *-e* e shumësit është refleks i indoevropianishtes $*ās$ dhe mendimi i Majerit që *-e*-ja është refleks i diftongut indoevropian $*oi$ nëpërmjet $*ai$ dhe është mbrojtur mendimi që origjina e saj duhet kërkuar në zhvillimin e brendshëm të shqipes (tek forma e shumësit të emrave femërorë të tipit *nuse*, që dalin njësoj si në njëjës dhe në shumë).

Është kundërshtuar gjithashtu mendimi i Majerit, që mbaresa *a* e shumësit është refleks i indoevropianishtes $*ās$ të shumësit të femërorëve me temë në $-ā$, si edhe mendimi i Hempit që *a*-ja vjen nga $*ans$ e kallëzores shumë dhe është miratuar mendimi i Pedersenit, simbas të cilit mbaresa *-a* e shumësit ka dalë nga shkrirja e *ë*-së fundores me mbaresën *-e*.⁶⁴

Objekt i një analize të veçantë është bërë kategorizimi gramatikor

59) E. Çabej, *Diskutim rreth kumtesës së S. Manit*, «Konferenca e parë e studi-meve albanologjike», f. 355; *Fonetika historike e shqipes*, f. 127.

60) E. Çabej, *Fonetika historike e shqipes*, f. 109.

61) E. Çabej, *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 3, f. 41; Sh. Demiraj, *Rreth mbaresave të shumësit të emrave asnjansë në gjuhën shqipe*, SF, 1968, 2, f. 139.

62) Sh. Demiraj, *Po aty*, f. 139.

63) M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, f. 7; Sh. Demiraj, *Po aty*, f. 140.

64) Sh. Demiraj, *Po aty*, f. 142, 143, 144.

i komponenteve të pronorëve. Këtu janë mbrojtur dy teza të ndryshme. Nga njera anë në pajtim me Pedersenin, është mbrojtur mendimi se elementet e para të pronorëve janë nyje të përparme, të cilat, kur kishin ende përbërjen fonetike të dëftorëve të thjeshtë (pa parashtesat deiktike *a-*, *k-*, u përngjiten me mbeturinat konsonantike të pronorëve origjinarë, të cilët nga ana e tyre kishin dalë nga adjektivizimi i përemrave vetorë në rasën gjindore⁶⁵. Kurse, nga ana tjetër, në pajtim me Bopin është mbrojtur mendimi që elementet e para të pronorëve janë përemra dëftorë të cilët u përngjitën me gjindoren e vetoreve.⁶⁶

2. Një punë frytëdhënëse është bërë për zbulimin e tipareve të shqipes së periudhës paraletrare, kryesisht mesjetare (para shek XVI).

Nëpërmjet të dhënave të ruajtura në të folmet e arbëreshëve të Greqisë e të Italisë, që janë shpërngulur përkatësisht në shek. XIV-XV, nëpërmjet fjalëve, frazave e fragmenteve shqipe të gjetura në tekste e akte të shkruara në gjuhë të huaja, nëpërmjet të dhënave të onomastikës të zbuluara në dokumenta e vepra historike, si edhe nëpërmjet të dhënave që dalin nga historia e marrëdhënjeve të shqipes me rumanishten e gjuhët e tjera fqinjë janë arritur rezultate edhe në rindërtimin e strukturës fonetike e morfologjike të shqipes në periudhën paraletrare, kryesisht mesjetare deri në shek. XVI.

Puna ka vazhduar në dy drejtime: a) në drejtim të zbulimit të burimeve dhe të inventarizimit të fjalëve shqipe të periudhës mesjetare të shqipes; b) në drejtim të zbulimit të tipareve të shqipes së periudhës paraletrare kryesisht mesjetare.

a) Me gjithë rezultatet që janë arritur në drejtim të zbulimit të burimeve dhe inventarizimit të fjalëve shqipe të kësaj periudhe⁶⁷, duhet pranuar se «letërsia historike shumë më e pasur që ekziston, e sidomos botimet dokumentare të këtyre 20 vjetve të fundit, dhe burimet e ndryshme arkivale që njohim tani, me materialet e pasura që përmbajnë, hapin në këto drejtime perspektiva të tjera, shumë më të mëdha, mundësira pak ose aspak të shfrytëzuara nga gjuhësia jonë deri më sot dhe një fushë të gjerë pune për filologjinë shqiptare dhe studimin historik të gjuhës sonë⁶⁸.

b) Në drejtim të zbulimit të tipareve të shqipes paraletrare, kryesisht mesjetare, rezultatet e arritura janë me interes dhe shënojnë fillimin e një pune që në të ardhmen, besojmë të shpjerë në rezultate të tjera më të rëndësishme.

Edhe këtu puna ka vazhduar në dy drejtime: 1) në drejtim të zbulimit të një faze më të vjetër të disa fenomeneve të shqipes së përbashkët; 2) në drejtim të zbulimit të disa fenomeneve dialektore e nëndialektore karakteristike për këtë fazë të shqipes.

1) Duke u nisur nga mënyra e theksimit të fjalës së rumanishtes *câlbează, gâlbează* «këlbazë», që vjen nga shqipja *këlbazë, gëlbazë* e kjo nga **kalbëzë*, është vërtetuar se në kohën e marrëdhënjeve të hershme me rumanishten «rregullimi mekanik i akcentit» me parimin e

65) BUSHT SSHSH, 1959, 2, f. 50-53.

66) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve...*, f. 77.

67) M. Domi, *Burime dhe materiale të shqipes së shekullit XV*, SF, 1968, 3, f. 69-81.

68) M. Domi, *Po aty*, f. 70.

theksimit të rrokjes së parafundit, në qoftë se nuk ishte kryer plotësisht, të paktën kishte marrë rrugën e këtij zhvillimi.⁶⁹

Po kështu, duke u nisur nga *cracium* «kërshëndella» e rumanishtes, që vjen nga shqipja *kërcun*, është arritur në përfundimin që në periudhën e rumanishtes së përbashkët në shqipe shqiptohej ende zanore + n në vend të zanores hundore karakteristike për gegërishten e sotme.⁷⁰

Duke u mbështetur në dëshminë e veprës së Buzukut, është mbrojtur mendimi se në shqipen paraletrare ka vazhduar të ruhet zanorja e reduktuar si edhe bashkëtingëllorja sonantike, që në shqipen e periudhës letrare (pas shek. XVI) del e reduktuar.⁷¹

Është vërtetuar nëpërmjet krahasimit të fjalëve të huazuara nga rumanishtja prej shqipes një fazë më të vjetër për tingujt *th*, *s*, *z* të shqipes së sotme.

Me fakte të reja është përforcuar mendimi i N. Joklit që spiranti interdental *th* ka dalë prej një afrikateje. Janë sjellë fjalë nga rumanishtja, që burojnë nga shqipja, të cilat provojnë një fazë më të mëtejme ç, *xh* të *s*, *z*.⁷²

Janë sjellë gjithashtu argumenta që provojnë një fazë të mesme *c*, *z* në rrugën e kalimit të *+k'*, *+g'*, respektivisht në *th*, *dh*.⁷³

Është vërtetuar me të dhënat e dokumentave dhe të fjalëve e frazave shqipe të gjetura nëpër dokumenta, si edhe nëpërmjet onomastikës historike një fazë më e vjetër e disa prej zhvillimeve të shqipes së përbashkët në periudhën paraletrare të shqipes, siç janë: qëndrueshmëria e -ë-së së patheksuar, varianti uo i grupit të zanoreve të përituar nga zërbërthimi i o-së, grupet (cl, gl, ll, lj) bashkëtingëllorja (nj).⁷⁴

Është mbrojtur mendimi që trajtat *grapă*, *brad* të rum., *škrapa* të serbokroatishtes, *scarpa* e arumanishtes ruajnë një formë më të vjetër të *grop*, *bredh*, *shkrep* të shqipes, gjë që hedh një dritë të re mbi historinë e metafonisë së shqipes.⁷⁵

Është provuar me të dhëna nga monumentet më të lashta të gjuhës sonë të shkruar vjetërsia e kompozitave në gjuhën shqipe, kurse me të dhëna nga onomastika e sidomos nga toponomastika historike është dokumentuar prania e disa prej tipave të vjetër e produktivë të kompozitave në shqipen e periudhës paraletrare, siç janë ato të tipit bahuvrihi.⁷⁶

2. Nga gjuhësia shqiptare në disa raste, në pajtim edhe me dijeta-

69) E. Çabej, *Disa faza më të mëtejme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinjë*, «Revistë shkencore», 1964, 1, f. 7 (Shih edhe botimin gjermanisht «Ältere Stufen des Albanischen im Lichte der Nachbarsprachen, në «Zeitschrift für Balkanologie», Jahrgang II, 1964, 8).

70) E. Çabej, *Po aty*, f. 10.

71) E. Çabej, *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 2, f. 87.

72) E. Çabej, *Disa faza më të mëtejme...*, f. 15-19.

73) E. Çabej, *Po aty*, f. 15-16.

74) E. Çabej, *Për historinë e konsonantizmit...*, f. 45-57; *Diftongje e grupe zanore...*, f. 75; *Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe*, BSHSH, 1956; 1, f. 123-146; *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955; 2, f. 86; K. Ashta, *Ndërrime të fjalës së shkrueme të arbërishtes si periudhë e mesme e historisë së gjuhës shqipe*, «Buletin shkencor», 1967, 6, f. 65-67; M. Domi, *Burime dhe materiale...*, f. 79; T. Osmani, *Vëzhgime për disa toponime e antroponime në veprën «Catasto veneto di Scutari» (1416-1417)*, «Buletin shkencor», 1967, 6, f. 93-94.

75) E. Çabej, *Disa faza më të mëtejme...*, f. 9.

76) A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, BUSHT SSSH, 1961, 3, f. 3-20.

rë të tjerë, është mbrojtur mendimi se një pjesë e veçorive dialektore e nëndialektore i përkasin periudhës para shek. XVI.

Në këtë grup fenomenesh janë përfshirë delabializimi i *o*-së së grupit *vo* në *va* në toskërishte⁷⁷, kalimi i *â*-së (< *a* + *n*) në *a* gojore ose në *ë* në toskërishte,⁷⁸ shurdhimi i okluziveve i spiranteve të zëshme në fund të fjalës e rotaçizmi i *n*-së intervokalike⁷⁹, si edhe disa fenomene nëndialektore si kalimi i *â*-së në *o*, i *u*-së në *o*, i *mj* në *nj*, i *gl*-së në *g*⁸⁰ dhe i *y*-së në *i* në të folmet e Gegërisë së Mesme⁸¹.

Rezultate janë arritur edhe në zbulimin e tipareve të strukturës morfologjike të shqipes në periudhën paraletrare, kryesisht mesjetare.

Duke u nisur nga gjuha e Buzukut, nga gjuha e shkrimtarëve pas tij dhe nga të dhënat dialektore, është dëshmuar se në një periudhë më të moçme të shqipes (para shek. XVI) asnjësi, mbiemrat e substitivuar dhe emrat foljorë kanë pasur një përdorim më të gjërë⁸².

Është mbrojtur mendimi që në një fazë të dhënë të zhvillimit të shqipes së përbashkët (jo më vonë se shekujt e fundit të sundimit romak në Shqipëri) emrat e gjinisë asnjësi, një shumë emrash të gjinisë femërore, si edhe një pjesë emrash të gjinisë mashkullore e formonin shumësin me mbaresën -ë, gjë që çoi më vonë në zhvillimin e prirjes për një diferencim të ri të formave të shumësit me anë mbaresash më shprehëse.⁸³

Është provuar për periudhën paraletrare të shqipes një ndikim i ndjeshëm i rasës emërore mbi rasat e zhdrejta të emrave, si edhe në të drejtat (*të vllat* > *të vllait*; *malnë*, *gjaknë* > *malin*, *gjakun*).⁸⁴

Barazia e kallëzores njëjës të emrave me emëroren njëjës të tyre në tekstin e Buzukut, është shikuar si ko incidencë fonetike e shkaktuar nga dobësimi i tingujve fundorë dhe jo si një shfaqje sinkretizmi rasor.⁸⁵

Është mbrojtur mendimi se nga dy rasat e shqipes së lashtë (gjindore-dhanore) gjindorja që ajo që trashigoi funksionet e dhanores, duke u bërë kështu e dykuptimshme. Në këto rrethana lindi nevoja e krijimit të një gjindoreje më të vonë me ndihmën e një elementi gjuhësor me përbërjen fonetike të nyjës po me funksionin sintaktik të një përemri dëftor.⁸⁶

Është mbrojtur gjithashtu mendimi që mbaresa -e e gjindores shumë do të ketë qenë gjetetivale dhe vetëm më vonë gjindorja filloi të shërbejë edhe si dhanore, kështu që trajtat buzukjane *njerzet*, *gravet* përfaqësojnë dhanore të vona. Në rrethana të njëjta edhe

77) E. Çabej, *Disa faza më të moçme...*, f. 7-8; *Hyrje në historinë...*, f. 72, 95.

78) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve...* f. 71.

79) E. Çabej, *Disa faza më të moçme...* f. 11; *Rreth disa çështjeve...* f. 71; *Fonetika historike...* f. 114-116.

80) E. Çabej, *Disa faza më të moçme...* f. 6-7; *Rreth disa çështjeve...*, f. 72.

81) B. Beci, *Rreth kronologjisë dhe shkaqeve historike që kanë përcaktuar kalimin e y-së në i në Gegëri të Mesme*, «Kongresi i Manastirit», Shkodër, 1963, f. 57-64.

82) E. Çabej, *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 3, f. 39.

83) Sh. Demiraj, *Rreth mbaresave të shumësit...*, SF, 1963, 2, f. 140.

84) E. Çabej, *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 3, f. 47, 49.

85) *Emrat në shqipe: sistemi i rasave dhe tipet e lakimit*, Tiranë 1965, f. 11.

86) *Po aty*, f. 22. Për vendosjen relativisht të vonë të përdorimit të nyjës së përparme në shqipe shih edhe E. Çabej, *Rreth disa çështjeve...*, f. 78-82.

mbaresa *-sh* e dhanore-rrjedhore shumë u specializua vetëm për rrjedhoren⁸⁷.

Duke u nisur nga përhapja dhe përgjithësimi i barabartë i ndërrimit të gjinisë së emrave në shumë (njëjës *vend i bukur*; shumë *vende të bukura*) në të folmet e dy dialekteve të shqipes dhe përhapja e tij e kufizuar në të folmet e arbëreshëve të Greqisë e të Italisë, është anuar nga përfundimi se ky fenomen nuk duhet të jetë tepër i lashtë në shqipen (jo më i vjetër se mesjeta e hershme). Është përjashtuar mundësia që ky fenomen të jetë përfutur në shqipen që në periudhën kur kjo gjuhë vazhdonte të ishte nën ndikimin e latinishtes⁸⁸.

Si veçori e përbashkët e gjuhës shqipe të periudhës paraletrare është pranuar e ashtuquajtura vendore me *-t*, e cila tek autorët e vjetër na del e përdorur rregullisht.

Në kundërshtim me shumicën e dijetarëve e në pajtim me Sandfeldin është mbrojtur mendimi që postpozicioni i artikullit në shqipe është më i vjetër se pozicioni proklitik dhe se ky i fundit ka rrjedhur prej atij në ngërthim të fjalisë me anë të një përsëritjeje.

Nga pikëpamja e sistemit morfologjik indoevropian që të dy artikujt janë shikuar si një inovacion në gjuhën shqipe. Është miratuar mendimi i M. La Pianës, i cili artikullin postpozitiv e çon tek një periudhë e shqipes, e cila ka qenë përpara hyrjes së huazimeve latine⁸⁹. E. Çabej, duke u nisur nga qëndrueshmëria në formë dhe në kuptim e postpozicionit dhe mosqëndrueshmëria e prepozicionit pranon një vjetërsi të madhe të postpozicionit dhe vendosjen relativisht të vonë të përdorimit në proklizë.⁹⁰

Është miratuar nga ana tjetër mendimi i V. Pisanit, që e kërkon burimin e artikullit postpozitiv tek një substrat paraindoevropian mesdhetar.⁹¹

Nga E. Çabej është mbrojtur mendimi që në një fazë të periudhës paraletrare, e cila nuk përcaktohet dot me saktësi, ndryshimi i gjinisë tek përemrat pronorë erdhi e u dobësua mjaft në vetëdijen gjuhësore, si ç'duket, për arsye se elementi i dytë i tyre (ynë, jonë) ka qenë po ai në të dyja gjinitë. Kjo mungesë u mënjanua me anë të fundoreve të emrave femërorë *-e*, *-a* (për njëjësin) e *-a* për shumësin. Kështu shpjegohet simbas tij, formimi i trajtave *eme*, *ime*, *jote*, *sate*, *tënde*, *sote*, e *tia*, e *saja* në shumë të *mia*, *të tua*, *tona*, *tuaja* etj. përkundrejt mashkullorevet: *im*, *yt*, *tit*, *tend*, *sit*, *i tij*, *i saj*, shumë të *mi*, *të tu*, *tanë*, *tuaj*.⁹²

Sh. Demiraj, në kundërshtim me tezën e Gabinskit se protoshqipja nuk ka pasur paskajore, ka miratuar mendimin që paskajorja e tipit *me ba* ka zëvendësuar një paskajore më të vjetër, e cila duhet të jetë zhdukur që herët pa lënë gjurmë. Është konsideruar si i gabuar dhe pa asnjë mbështetje historike e gjuhësore pikëpamja tjetër e Ga-

87) *Emrat në shqipe: sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit*, Tiranë, 1965, f. 27-28.

88) Sh. Demiraj, *Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në shumë në shqipe vështruar edhe në përjasje me rumanishten*, SF, 1966, 4, f. 87-91.

89) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve...* BUSHT SSHSH, 1963, 3, f. 78-79; Për vjetërsinë më të madhe të postpozicionit se prepozicionit shih edhe «Buletin Shkencor», 1964, 1, f. 23-24.

90) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve...* BUSHT SSHSH, 1963, 3, f. 79.

91) E. Çabej, *Diskutim rreth kumtesës së V. Pisanit, «Origjina e gjuhës shqipe»*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», f. 348.

92) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve...* BUSHT SSHSH, 1963, 3, f. 77.

binskit, simbas së cilës zhdukja e infinitivit me *me* në toskërishte duhet shpjeguar me ndikimin e një «substrati grek».⁹³

Është pranuar dhe argumentuar më tej me të dhëna nga materiali i gjuhës së folur dhe të shkruar nga Buzuku e këtej mendimi i Majerit, simbas të cilit *-ë-ja* e pjesores është një mbeturinë e formantit *-në* të pjesores, *n* e së cilës është asimiluar nga bashkëtingëllorja fundore e temës, kur kjo ka qenë një likuide (*r, l, l'*)⁹⁴ dhe është konsideruar i papranueshëm mendimi i Majerit, simbas të cilit edhe *+li-dhnë, viedhnë, dredhnë* duhet të kishin dhanë *lidhë, viedhë, dredhë*. Është sjellë për këtë si argument fakti që asimilimi i grupit *dhn* në *dh* është një fenomen analogjik i përhapur këto dy-tre shekujt e fundit, sidomos në toskërishten veriore, të cilin nuk e ndeshim te Buzuku⁹⁵.

3. Vëmendja kryesore e gjuhësisë shqiptare në studimin e historisë së gjuhës është përqëndruar, sikundër u tha, në studimin e zhvillimit të shqipes në periudhën e saj të re (nga shek. XVI e këtej). Si burime themelore për zbulimin e zhvillimeve në sistemin fonetik e morfologjik të shqipes të kësaj periudhe kanë shërbyer, më një anë, të dhënat e sotme të dialekteve e, më anë tjetër, veprat e shkrimtarëve tanë të shek. XVI, XVII, XVIII.

Edhe studimi i shqipes së periudhës së re ka shkuar në dy drejtime themelore: 1) në drejtim të zbulimit të veçorive fonetike e morfologjike të gjuhës së autorëve tanë XVI-XVIII⁹⁶; 2) në drejtim të studimit të historisë së fenomeneve dialektore të vëna re në këtë periudhë.

Për realizimin e pikësnyimit të parë, është shfrytëzuar metoda përkthuese e kombinuar ndonjëherë me të dhënat e metodës statistikore, kurse për realizimin e pikësnyimit të dytë metoda krahasuese e brendshme, nga njëra anë, ndërmjet vetë të dhënave të këtyre veprave dhe, nga ana tjetër, ndërmjet të dhënave të këtyre veprave me të dhënat e dialekteve të shqipes e të të folmeve të ngulimeve shqiptare.

1) Në zbulimin e veçorive të shqipes në shek. XVI një kontribut të vyer ka dhënë E. Çabej me punimet e tij mbi veçoritë e sistemit fonetik morfologjik të gjuhës së veprës së shek. XVI, «Meshari» të shkruar nga Gjon Buzuku⁹⁷. Interes për zbulimin e veçorive të sistemit fonetik morfologjik e leksikor të veprave të shek. XVI kanë edhe punimet e shkruara nga K. Ashta për veprën e Buzukut dhe veprën e Lek Matrangës.

Dy artikujt të veçantë i janë kushtuar përkthimit të trajtave të ndryshme të mënyrës urdhërore të foljeve veprare e pësore në njëjës

93) Sh. Demiraj, *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe*, SF, 1969, 1, f. 95.

94) M. Totoni, *Trajtat e pjesores së foljeve me temë më likuide në toskërishten*, SF, 1965, 4, f. 138-139. Sh. Demiraj, *Rreth disa problemeve të paskajores...*, SF, 1969, 1, f. 89.

95) M. Totoni, *Punim i cituar*, f. 137-139.

96) Studimet për historinë e gjuhës letrare kombëtare nuk i kemi përfshirë në këtë artikull. Simbas A. Kostallarit «bazat e gjuhës letrare kombëtare shqipe janë hedhur në shek. XIX me «Evetarin shqip» të N. Veçilharxhit (Shih A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, «Shkencaat shoqërore në shkollë», 1960, f. 62, botuar në një variant të dytë edhe në «Studia Albanica», 1966, 2, f. 3-30).

97) E. Çabej, *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 2, f. 81-100; 1955, 3, f. 39-50; 1955, 4, f. 113-125; *Trajtimi i zanores iniciale të Gjon Buzukut*, BUSHT SSHSH, 1957, 1 (3), f. 96-102; «Meshari» i Gjon Buzukut, 1955, Botim kritik, Tiranë 1968, I, hyrje f. 7-101.

dhe shumë, si edhe përshkrimi të trajtave të pjesores në veprën e Buzukut e ilustruar kjo edhe me të dhëna statistikore.⁸⁹

Një kontribut i vlefshëm është dhënë për zbulimin e veçorive të sistemit fonetik, morfologjik, sintaktik e leksikor të gjuhës së shek. XVII ashtu siç paraqitet ajo në veprat e P. Budit.⁹⁰

Objekt i një shqyrtimi të veçantë është bërë përshkrimi i pronoreve të shqipes ashtu siç paraqiten ata tek autorët e vjetër si edhe përshkrimi i disa fenomeneve vokalice në veprën «Kuvendi i Arbënit» të shek. XVIII.¹⁰⁰

Një vështrim të thjeshtuar në përputhje me destinacionin e tekstit mbi veçoritë grafiko-ortografike dhe gjuhësore të gjuhës së autorëve të vjetër gjejmë në dispensën «Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe».¹⁰¹

2) Duke përqasur të dhënat e veprave të autorëve të vjetër dhe të onomastikës historike mbas shek. XVI me të dhënat e dialekteve e nëndialekteve të gjuhës shqipe, është vërtetuar se zhdukja e shpeshtë e *ë*-se së patheksuar¹⁰², reduktimi i diftongjeve të mirëfillta e të pamirëfillta *je, ie, ye, uo* e *ue* në zanore të thjeshta të gjata në gegërishte janë zhvilluar në periudhën mbas shek. XVI.¹⁰³

Si të kësaj periudhe janë përcaktuar edhe këto fenomene konsonantike të gegërishtes: kalimi i bashkëtingëllores *nj* në *j*, asimilimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ngj* respektivisht në *m, n, nj*, labializimi i *h*-së në *f*, si edhe kalimi i grupit të bashkëtingëlloreve *fsh* në *sh* në gegërishten veriore, asimilimi i grupeve *kl, gl* respektivisht në *q, gj* në të dy dialektet dhe kalimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *lk, lg* respektivisht në *jk, jg*.¹⁰⁴

Gjeografikisht pikënisja e këtyre zhvillimeve është kërkuar në dialektet qendrore të gegërishtes.¹⁰⁵

Objekt i një trajtimi të veçante është bërë përcaktimi i shkakut të zbrërthimit të diftongjeve *ua/ue, ie, ye* në togje zanoresh në të folmet e shqipes. Është mbrojtur mendimi se diftongjet *u* zbrërthyen në ato të folme, ku është ruajtur gjatësia; pikëpamja që e kërkon

98) K. Ashta, *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555)*, «Revistë shkencore», 1964, 1, f. 97-130; «Buletin shkencor», numër i posaçëm, 1964, f. 119-184; 1965, f. 49-97; 1966, f. 27-67; *Shënime e vërejtje rreth gjuhës e leksikut të Lekë Matrangës*, BSHSH, 1957, 1, f. 83-108.

E. Lafe, *Trajtat e urdhërores së Gjon Buzukut*, SF, 1965, 1, f. 163-169; *Trajtat e pjesores së Gjon Buzukut*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», f. 154-160.

99) K. Cipo, *Vërejtje fonetike, morfologjike e sintaktike mbi «Doktrinën e Kërshenë» të Budit*, BSHSH, 1952, 1, f. 5-13.

E. Çabej, *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*, SF, 1966, 4, f. 139-148. K. Ashta, *Rreth disa çështjeve të leksikut të Pjetër Budit*, SF, 1966, 4, f. 159-165.

100) K. Ashta, *Shënime mbi vokalizmin në veprën «Kuvendi i Arbënit» (1706)* «Buletin i Institutit të naltë pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës», 1957, f. 45-54. BUSHT, SSHSH, 1959, 3, f. 34-55.

101) *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe, Krestomati thjeshtë gjuhësore*, Tiranë 1961 (dispensë).

102) E. Çabej, *Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe*, BSHSH, 1, 1956, 1, f. 123-146; *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 2, f. 86.

103) E. Çabej, *Diftongje e grupe zanoresh...*, BUSHT SSHSH, 1958, 3, f. 71-88, *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 2, f. 88-90.

104) E. Çabej *Për historinë e konsonantizmit...* f. 31-81; *Disa faza më të moçme...* f. 19, 22, 23; *Gjon Buzuku*, 1955, 2, f. 92, 93, 94, 96, 97, 98.

105) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve...* f. 70.

shkakun e këtij zhvillimi të shpërngulja e theksit është konsideruar e padrejtë.¹⁰⁶

Janë bërë përpjekje dhe janë arritur rezultate edhe në përcaktimin e kronologjisë së katër prej fenomeneve më karakteristike të të folmeve të Gegërisë së Mesme, të diftongimit të *i*-së së theksuar, të palatalizimit të *g*-së në *gj*, të *tj*, *dj* në *q*, *gj*. Është mbrojtur mendimi që diftongimi i *i*-së së theksuar në fillim të shek. XV ishte i gjallë.¹⁰⁷

Gjuhësia shqiptare, duke u nisur nga fakti se ndryshimet dialektore që vihen re sot midis dy dialekteve të shqipes në pjesën më të madhe i përkasin periudhës së re të saj, ka mbrojtur mendimin që degëzimi dialektor i shqipes në gegërishte e toskërishte është relativisht i ri. Është vertetuar gjithashtu që toskërishtja e mbarimit të mesjetës, ashtu si shfaqet ajo në të folmet e ngulimeve shqiptare të Greqisë e të Italisë, qëndron më afër gegërishtes veriore të shek. XVI-XVII, e pasqyruar në monumentet letrare, nga ç'afrohen sot dy dialektet kryesore në mes tyre. Përveç kësaj, është arritur në përfundimin se këto tipare nuk kanë dalë të gjitha njëkohësisht po një pas një e shkallë-shkallë, dhe se gjatë periudhës letrare është treguar më konservative toskërishtja, kurse gjatë periudhës paralettrare gegërishtja.¹⁰⁸

Është hedhur poshtë përpjekja e V. Polakut për të shpjeguar ndarjen dialektore të shqipes në dy dialekte me ndikimin e dyfishtë sllav dhe është mbrojtur pikëpamja që e kërkon burimin e këtyre ndryshimeve në zhvillimin e brendshëm të gjuhës shqipe.¹⁰⁹

Një kontribut i vyer është dhënë edhe në zbulimin e fenomeneve të strukturës morfologjike të shqipes në përgjithësi në periudhën e saj të re.

Ndryshimet themelore që janë vënë re në sistemin lakor nominal të shqipes në periudhën mbas shek. XVI janë këto: 1) dalje jashtë përdorimit e rrjedhore së shquar «prej burrashit»; 2) kufizimi i konsiderueshëm i rrjedhore së pashquar «prej burrash» në të mirë të dhanorevet përkatëse: «prej burrave»; «prej ca burrave»; 3) zhdukja e nënlakimit femëror «emër. (një) pushtet (pushtetja), dhan. (një) pushtetje (pushtetse)» në të mirë të mashkullorit: emër. (një) pushtet (pushteti), dhan. (një) pushteti (pushtetit); 4) rrafshimi i përfunduar i dy mbaresave -ve, -e të dhanores shumë në të mirë të së parës¹¹⁰; 5) zëvendësimi i «vendores» me -t me formën e re të kallëzores¹¹¹.

Këto janë disa nga çështjet themelore që u rrahën, si edhe disa nga mendimet kryesore, që u parashtruan nga gjuhësia shqiptare e pasqirimit në lëmin e studimit të historisë së jashtme e të brendshme të shqipes.

Siç del edhe nga kjo pasqyrë e rezultateve të arritura, rrethi i problemeve të trajtuara është relativisht i madh; ai rrok të gjitha periudhën

106) J. Gjinari, *Diftongjet ua/ue ie dhe ye në të folmet e gjuhës shqipe*, SF, 1968, 1, f. 97-104.

107) B. Beci, *Mbi katër inovacione fonetike të të folmeve të Gegërisë së Mesme*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», f. 261-270.

108) E. Çabej, *Disa faza më të moçme..* f. 6; *Zur Geschichte der mundartlichen Struktur des Albanischen*, «Zeitschrift für Mundartforschung.» Beihefte Neue Folge Nr. 3 Verhandlungen des zweiten internationalen Dialektologenkongresses I Weisbaden 1967, f. 136-145; *Disa probleme themelore...*, BUSHT SSHSH, 1963, 3, f. 70.

109) J. Gjinari, *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, SF, 1968, 4, f. 127-144 (botuar frengjisht edhe në «Studia Albanica», 1969, 1, f. 107-124).

110) Emrat në shqipe... f. 36; E. Çabej, *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 3, f. 47-48.

111) E. Çabej, *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 4, f. 117.

dhat e zhvillimit të shqipes që nga periudha e shkëputjes së saj nga bashkësia indoevropiane e deri në ditët e sotme, pjesën më të madhe të niveleve të strukturës fonetike e morfologjike të shqipes.

Duhet pranuar se 25 vjet janë një kohë relativisht e shkurtër për ndriçimin e zhvillimit historik të një gjuhe kaq të lashtë si kjo jona dhe e dokumentuar mjaft vonë.

Kjo bëhet edhe më e kuptueshme, po të kemi parasysh që grumbullimi sistematik i materialeve dialektore ka filluar vetëm pas çlirimit.

Në këto rrethana bëhet e qartë që shumë probleme ende të patrajtuara presin të trajtohen, shumë probleme të trajtuara, por të pazgjithura deri në fund presin zgjidhjen përfundimtare.

Zgjerimi i bazës materiale nëpërmjet zgjerimit të mëtejshëm të grumbullimit të materialeve të të folmeve të shqipes dhe të të folmeve të diasporës shqiptare, nëpërmjet hulumtimit të dokumentave të shkrimit e të dhënave të onomastikës historike, nëpërmjet thellimit të kërkimeve e shfrytëzimit akoma më të gjerë të metodës krahasuese me gjuhët e tjera dhe të metodës së rikonstruktimit të brendshëm, përbëjnë disa nga rrugët që do t'i japin mundësi gjuhësisë shqiptare në të ardhmen për të arritur një zgjidhje objektivist më të plotë të problemeve që shtron studimi i historisë së shqipes, duke e bërë atë një bazë të shëndoshë për zgjidhjen e mjaft problemeve të së sotmes së gjuhës shqipe e të perspektivës së saj.

R é s u m é

REALISATIONS DE LA LINGUISTIQUE ALBANAISE DANS L'ETUDE DE L'HISTOIRE DE LA LANGUE ALBANAISE DURANT CES 25 ANNEES

Dans l'article en question sont exposés quelques-uns des résultats obtenus dans l'étude de l'histoire de la langue albanaise par la linguistique albanaise après la libération du pays.

Les traits fondamentaux des recherches dans le domaine de l'histoire de la langue albanaise de ces 25 dernières années, sont, d'après l'auteur, les suivants:

1. A différence de l'albanistique étrangère de la deuxième moitié du XIX^e et de la première moitié du XX^e siècles, qui s'était posée la tâche d'étudier l'histoire extérieure de l'albanais, la linguistique albanaise d'après la libération s'est posé la tâche fondamentale d'étudier l'histoire de son développement intérieur.

Néanmoins on doit admettre que «par l'attention que consacra H. Pedersen aux faits de la langue albanaise elle-même et à la reconstruction intérieure sur la base de l'étude historique comparative, commence à se délinéer une nouvelle direction dans l'albanistique étrangère, consolidée plus tard par N. Jokl, M. Lambertz, H. Barié, et d'autres.» Pourtant, cette voie qui dans cette période peut être considérée dans ses premiers pas, constitue actuellement le trait fondamental des recherches dans le domaine de l'étude de l'histoire de la langue albanaise.

2. Tandis que l'albanistique étrangère élaborait les problèmes de l'histoire de l'albanais en s'appuyant sur un matériel limité du domaine de l'albanais, la linguistique albanaise d'après la libération a élaboré ces problèmes en s'appuyant sur une plus ample base de faits du domaine de l'albanais. Cette base est le résultat d'un ample travail systématique pour la réunion des matériaux dialectaux durant ces 25 ans ainsi que du travail fait pour la transcription des productions des auteurs anciens.

3. La modification de l'objet a déterminé aussi les changements dans la méthode appliquée. Si l'albanistique étrangère a employé surtout la méthode de la linguistique historique comparative, la linguistique albanaise a mis au centre de son attention la méthode de la reconstruction intérieure, sans abandonner aussi la méthode comparative traditionnelle. Tout cela a permis de rapprocher l'étude de l'histoire de la langue albanaise plus près des problèmes de l'époque, en permettant ainsi que celle-ci, quoique historique, serve de mieux en mieux et d'une façon plus directe à la solution des tâches de l'aujourd'hui et de la perspective.

L'étude de l'histoire de la langue albanaise durant ces 25 ans a marché sur les deux directions principales suivantes: 1) sur la direction de la synthèse critique des réalisations obtenues dans ce domaine par la science linguistique, notamment dans la période vers la moitié du XIX^e siècle, lorsque Franz Bopp argumenta définitivement l'appartenance de l'albanais à la famille linguistique indo-européenne et jusqu'à la moitié du XX^e siècle; 2) sur la direction de l'approfondissement de l'argumentation ultérieure de plusieurs problèmes traités antérieurement, ainsi qu'en soulevant et donnant la solution à plusieurs nouveaux problèmes.

La synthèse du patrimoine passé dans le domaine de l'histoire de la langue albanaise, de la phonétique et de la morphologie historique a été faite dans les deux travaux importants, publiés sous forme de manuels, respectivement par E. Çabej et M. Domi, le premier sous le titre: I. Instruction à l'histoire de la langue albanaise; II. La phonétique historique de l'albanais, et le deuxième sous le titre: La morphologie historique de l'albanais. Dans ces travaux, outre la généralisation critique des résultats obtenus dans ce domaine depuis la moitié du XIX^e et jusqu'à la moitié du XX^e s., notamment par les albanologues étrangers, ont été formulées aussi plusieurs hypothèses nouvelles, dont quelques-unes ont fait plus tard l'objet d'études spéciales.

Ces travaux, outre les difficultés de caractère scientifique, ont surmonté aussi plusieurs difficultés de caractère méthodique. On est parvenu ainsi à broser sous une forme systématisée les lignes fondamentales du développement de l'albanais depuis sa période préhistorique jusqu'à nos jours.

Les questions fondamentales approfondies et argumentées plus loin, les nouveaux problèmes soulevés et résolus par la linguistique albanaise après la libération dans le domaine de l'étude historique de l'albanais portent: I. sur l'élucidation plus à fond des problèmes de son histoire extérieure; II. sur la mise au jour des éléments du système phonétique et morphologique ainsi que des lois qui ont agi durant les différentes périodes de son évolution.

I. Les problèmes fondamentaux débattus par la linguistique albanaise d'après la libération dans l'étude de son histoire extérieure sont: 1) Le caractère indo-européen de l'albanais; 2) La place de l'albanais dans le cercle des langues voisines; 3) Le berceau prébalkanique des Albanais; 4) Le berceau balkanique des Albanais; 5) Le problème des origines de l'albanais; 6) Les rapports de l'albanais avec le grec ancien, le latin balkanique, le roumain, les langues slaves et le turc.

De ceux-ci ont attiré davantage l'attention et ont été élucidés plus amplement le problème du berceau balkanique des Albanais (leur autochtonité) et celui des origines de l'albanais. Il s'agit de problèmes importants non seulement pour l'histoire de la langue albanaise mais aussi pour celle du peuple albanais et des autres peuples des Balkans anciens. C'est précisément dans la solution de ces problèmes, fait observer l'auteur, que les représentants de l'albanistique étrangère n'ont pas échappé à des estimations subjectives et aprioristiques. La linguistique albanaise a visé de marcher, dans l'élucidation de ces problèmes, à une cadence aussi mesurée que possible et d'être plus objective.

Elle a donné une contribution spéciale à surmonter les «raisons linguistiques» invoquées par G. Weigand en faveur de son opinion sur la migration des Albanais des régions plus à l'Est dans les parties occidentales à côté de l'Adriatique, vers la fin des temps antiques ou dans le haut moyen âge. D'autre part, elle a porté une série d'arguments nouveaux du domaine de la toponomastique et du lexique maritime de l'albanais, de celui des rapports de l'albanais avec le grec antique et le latin, au point qu'on considère désormais vieillie l'hypothèse de Weigand et ses variantes défendues par d'autres spécialistes.

La linguistique albanaise, en collaboration aussi avec l'ethnologie et l'archéologie, s'est rapprochée de plus en plus, par les arguments invoqués, à la solution du problème de l'ethnogenèse du peuple albanais. Une valeur particulière assument dans cette voie les travaux: Questions de l'histoire de l'albanais, Problèmes fondamentaux de l'histoire antique de la langue albanaise, La contribution de l'albanais à la ligue linguistique balkanique, Le problème de l'autochtonité de l'albanais à la lumière des noms de lieux d'E. Çabej, qui unissent en un les acquisitions obtenues par l'albanistique étrangère avec les nouvelles acquisitions de l'auteur en faveur de la thèse illyrienne des origines de l'albanais.

L'auteur fait remarquer que dans plusieurs articles a été mise en évidence la contribution de l'albanais à la formation du voisinage linguistique balkanique. Il a été donné un tableau objectivement plus exact du caractère des rapports de l'albanais avec les autres langues des Balkans en accordant, en opposition avec l'albanistique étrangère, la place due aux éléments de l'albanais empruntés de ces langues.

II. La mise au clair des éléments du système phonétique et morphologique de l'albanais, de même que celle des lois qui ont agi durant les différentes périodes de son développement, notamment dans sa période nouvelle (siècle XVI^e et en-de-çà) a été au centre de l'attention des recherches sur l'histoire de l'albanais.

1. Des efforts ont été faits et de nouveaux résultats ont été obtenus à l'aide de la méthode comparative dans la détermination des lois qui ont agi dans le reflet des sons et de la structure morphologique de l'indo-européen en albanais.

Il est noté que dans ce domaine la linguistique albanaise a admis,

en général, les principaux résultats positifs obtenus antérieurement par les albanologues étrangers et, en quelques points, elle les a faits siens et portés encore plus loin ces résultats.

2. Une activité féconde a eu lieu dans la découverte des traits de l'albanais dans la période pré-littéraire, notamment médiévale.

C'est au moyen des données conservées dans les parlers des Albanais de la Grèce et de l'Italie, qui s'y sont installés dans ces cinq derniers siècles, et peut-être plus antérieurement encore, au moyen des mots, des phrases et des fragments albanais glanés dans des textes et des actes écrits en langues étrangères, au moyen des données de l'onomatistique mises au jour dans des documents historiques, ainsi qu'au moyen de données qui résultent de l'histoire des rapports de l'albanais avec les autres langues voisines, qu'ont été obtenus des résultats aussi dans la reconstruction de la structure phonétique et morphologique de l'albanais, surtout médiéval. Le travail a continué dans deux directions: a) découvrir les sources et inventorier les mots albanais de la période médiévale de l'albanais; b) découvrir les traits de l'albanais pré-littéraire, surtout médiéval.

a) Malgré les résultats obtenus dans la direction de la découverte des sources et de l'inventaire des mots albanais de cette période, l'auteur admet que «la littérature historique de beaucoup plus riche qui existe, et notamment les publications documentaires de ces 25 dernières années, ainsi que les différentes sources d'archives que nous connaissons maintenant, les riches matériaux qu'elles contiennent, ouvrent dans cette voie d'autres perspectives, de beaucoup plus grandes, des possibilités peu ou point exploitées par notre linguistique jusqu'à nos jours et un vaste champ de travail pour la philologie albanaise et l'étude historique de notre langue.»

b) Sur le chemin de la découverte des traits de l'albanais pré-littéraire, surtout médiéval, le travail a marché en deux directions: 1) mettre au jour une phase plus ancienne de quelques phénomènes de l'albanais commun; 2) découvrir certains phénomènes dialectaux et subdialectaux, caractéristiques à cette phase de l'albanais.

La principale attention de la linguistique albanaise dans l'étude de l'histoire de l'albanais a été centrée, dénote l'auteur, sur l'étude de l'évolution de l'albanais dans sa nouvelle période (à partir du XVI^e siècle). En tant que sources fondamentales permettant de mettre au jour les évolutions dans le système phonétique et morphologique de l'albanais de cette période ont servi, d'une part, les données actuelles des dialectes, et d'autre part, les oeuvres de nos écrivains des siècles XVI, XVII, XVIII.

Aussi l'étude de l'évolution de l'albanais de la nouvelle période a emprunté deux directions principales: 1) celle de la mise au jour des particularités phonétiques et morphologiques de la langue de nos auteurs des siècles XVI-XVIII; 2) celle de l'étude de l'histoire des phénomènes dialectaux tardifs dans cette période.

Pour la réalisation du premier but a été employée la méthode descriptive, tandis que pour celle du deuxième but on a eu recours à la méthode comparative intérieure, d'une part, entre les données de ces productions et, d'autre part, entre les données de ces oeuvres comparées à celles des dialectes de l'albanais et des parlers de la diaspora albanaise.

En partant du fait que les différences dialectales qu'on observe à

l'heure que nous sommes entre les deux dialectes de l'albanais appartiennent, dans leur plus grande partie, à la nouvelle période de la langue, la linguistique albanaise a soutenu l'opinion que l'embranchement dialectal de l'albanais en guègue et en tosque est relativement récent. Il a été confirmé également que le tosque de la fin du moyen âge, ainsi qu'il se manifeste par le parler des installations albanaises de la Grèce et de l'Italie, se situe plus près du guègue septentrional des siècles XVI-XVII, reflété dans les monuments littéraires, que n'en sont pas rapprochés actuellement les principaux dialectes entre eux. De même a été soutenue l'opinion que ces traits n'ont pas poussé tous dans le même temps mais par degrés et que durant la période littéraire c'est le dialecte tosque qui s'est montré plus conservateur, tandis que dans la période prélettrée ce phénomène était le propre du guègue.

Ceux-ci sont, dans leurs lignes générales, d'après l'auteur, quelques-uns des problèmes fondamentaux débattus et les résultats obtenus par la linguistique albanaise de l'après-libération du pays dans l'étude de son histoire extérieure et intérieure.

L'auteur fait remarquer que le cercle des problèmes traités est relativement grand: il comprend toutes les périodes de l'évolution de l'albanais, depuis la période de sa scission de la communauté indo-européenne et jusqu'à nos jours, la plus grande partie des niveaux de la structure phonétique et morphologique de l'albanais, en admettant que 25 années représentent une époque relativement brève pour l'élucidation de l'évolution historique d'une langue aussi antique que l'albanais et documentée aussi tard. Cela devient encore plus compréhensible si l'on tient compte que l'amas systématique des matériaux dialectaux n'a commencé qu'après la libération du pays.

Dans ces circonstances on voit à l'évidence que plusieurs problèmes encore non abordés attendent leur traitement; plusieurs problèmes non traités mais non résolus à fond attendent leur solution définitive.

Dans son article, l'auteur a brossé aussi quelques-unes des principales voies pour une solution objectivement plus exhaustive des problèmes que soulève l'étude de l'histoire de l'albanais. Cela en vue de rendre d'elle une base solide à élucider plusieurs problèmes du passé et notamment de l'actualité et de la perspective.

